# P8. Mjedisi dhe Mbrojtja e Pyjeve dhe Kullotave

**" Mbrojtja e mjedisit, ruajtja dhe përmirësimi i tij, parandalimi dhe pakësimi i rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të qytetareve, përmes bashkëpunimit me komunitetin e Bashkisë e shoqerinë civile.”**

Rr. 13 Dhetori nr.1
4001 Shkodër - AL
+35522400150
info@bashkiashkoder.gov.al
bashkiashkoder.gov.al

Përmbajtja


P8. Mjedisi dhe Mbrojtja e Pyjeve dhe Kullotave 3
1. Hyrje 3
2. Politikat e zhvillimit 3
3. Funksionet: 4
3.1. F1. Zbatimi i dispozitave ligjore nëpërmjet strategjive, programeve dhe projekteve të cilat synojnë përmiresimin e vazhdueshëm të mjedisit dhe të përbërësve të tij. 4
3.1.1. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F1.O1 4
3.1.2. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F1.O2 4
3.1.3. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F1.O3 5
3.2. F2. Ndërgjegjesimi i banorëve nëpërmjet promovimit të politikave edukuese për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit 5
3.2.1. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F2.O1 5
3.2.2. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F2.O2 6
3.3. F3. Mbrojtjen dhe përmiresimin e mjedisit ujor, të ujërave sipërfaqësore, lumenjve dhe liqenit, ujrave nëtokesore etj. nëpërmjet shfrytëzimit racional të burimeve ujore, shpërndarjen e drejtë të tyre sipas qëllimeve të përdorimit si edhe mbrojtjen e tyre nga ndotja. 6
3.3.1. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F3.O1 6
3.3.2. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F3.O2 6
3.3.3. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F3.O3 7
3.4. F4. Administrimin e pyjeve dhe kullotave vendore si dhe menaxhimin e institucioneve në shërbim të këtij funksioni, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj. ndotja. 7
3.4.1. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F4.O1 8
3.4.2. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F4.O2 8
3.4.3. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F4.O3 9
4. Buxhetimi i programit të Mjedisit dhe Mbrojtjes së Pyjeve dhe Kullotave 10
5. Projektet dhe aktivitetet e planifikuara për mjedisin dhe mbrojtjen e pyjeve 12

## P8. Mjedisi dhe Mbrojtja e Pyjeve dhe Kullotave

### 1. Hyrje

Bashkia e Shkodrës, sot shtrihet në një territor rreth 760 km² dhe në kushtet e reja të krijuara kërkohet krijimi i ballancave të qëndrueshme të ruajtjes së mjedisit në tërësi, burimeve natyrore ujore mbrojtjes së tokave, administrimit të qëndrueshëm të pyjeve e kullotave. Sfida për të realizuar këtë balancë të qëndrueshmë mjedisore është e madhe dhe e vështirë referuar edhe larmishmërisë së tërritorit dhe problematikave që mbart sejcili sistem territorial.

Aktualisht brenda territorit administrativ të Bashkisë Shkodër gjendet një nga pellgjet ujëmbledhës më të mëdhenj në vend me një sipërfaqe prej rreth 19340 km² ( Shala, Kiri, Buna e Drini) ku impakti i tij në territor është shume i madh. Vetëm brenda territorit administrativ të Bashkisë Shkodër kemi një gjatësi vije lumore ( Drin, Bunë , Kir) rreth 168.7 km. Vetëm vija liqenore është 24.3 km ndërsa ajo bregdetare 14 km.

Pyjet e Bashkisë Shkodër zenë rreth 50% te territorit administrativ të saj me një siperfaqe prej rreth 43807.4 ha. Ku rreth 30992 ha jane pyje, rreth 5377.6 ha jane kullotë dhe sipërfaqja tjetër është bimësi pyjore, inproduktive etj. Pyjet kontribuojnë në mënyrë efektive në zhvillimin e qëndrueshëm, nëpërmjet sigurimit të mirëqenies njerëzore, sigurojnë një mjedis të shëndetshëm dhe mbështesin zhvillimin ekonomik të zonës në tërësi. Potenciali unik i pyjeve mbështet një ekonomi të gjelbër, cilësinë e jetës dhe ndikon në zbutjen e ndryshimeve klimatike.

### 2. Politikat e zhvillimit

Programi i Mjedisit dhe Mrojtjes së Pyjeve e Kullotave mbështetet në këto politika themelore.

> Mbrojtjen e mjedisit, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të qytetareve, përmes bashkëpunimit me komunitetin e Bashkisë e shoqerinë civile. Rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit gjithperfshires ne fushen e mbrojtjes se natyres ne bashkepunim me te gjitha institucionet rajonale dhe jo vetem per ndalimin e humbjes se biodiversitetit por edhe permiresimit te statusit te tyre.

> Mbrojtjen dhe përmiresimin e mjedisit ujor, të ujerave sipërfaqesore, lumenjve dhe liqenit, ujrave nëtokesore etj. Shfrytëzimin racional të burimeve ujore, shpërndarjen e drejtë te tyre sipas qëllimeve të përdorimit si edhe mbrojtjen e tyre nga ndotja.

> Zhvillimin e qëndrueshëm dhe shumë funksional të burimeve pyjore dhe kullosore, që të sigurojnë ekuilibrin biologjik të ekosistemeve pyjore, ruajtjen e sipërfaqeve pyjore, rritjen e prodhimtarisë dhe aftesisë ripërtritëse të pyjeve, parandalimin e degradimit të mëtejshëm të tokës.

Ligji nr 139/2015 " Për vetqeverisjen vendore" si edhe ligjet specifike mbi të cilën mbështetet veprimtaria e Bashkia Shkodër në sektorin e Mjedisit, Ujrave dhe Administrimit të Pyjeve , ka përcaktuar qartë funksionet , objektivat specifik për sejcilin funksion si edhe aktivitetet në funksion të tyre.

## 3. Funksionet:

### 3.1. F1. Zbatimi i dispozitave ligjore nëpërmjet strategjive, programeve dhe projekteve të cilat synojnë përmiresimin e vazhdueshëm të mjedisit dhe të përbërësve të tij.

**F1.O1. Zbatimi i masave të propozuara të VSM-ve, PPV Bashkia Shkodër, si dhe VNM-ve për projektet e propozuara:**

- Është realizuar hartimi i raportit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor për të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër në kuadër të hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor.Vlefshmëria e këtij Raporti dhe orjentimet e tij kanë jetëgjatësinë e Planit të Përgjithshëm Vendor , 15 vjet.
- Është miratuar Deklarata Mjedisore nga Ministri i Mjedisit , për VSM të PPV.

| Situata e synuar 2017 | Situata e synuar 2018 | Situata e synuar 2019 |
|---|---|---|
| **Zbatimi i objektivave mjedisore të Planit te Përgjithshëm Vendor, Bashkia Shkodër.** | Zbatimi i objektivave mjedisore të Planit te Përgjithshëm Vendor, Bashkia Shkodër | Zbatimi i objektivave mjedisore të Planit te Përgjithshëm Vendor, Bashkia Shkodër |

#### 3.1.1. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F1.O1

| Aktiviteti | Buxheti në mijë lekë |
|---|---|
| **P8.F1.O1.A1** Zbatimin e dispozitave ligjore nëpërmjet strategjive, programeve dhe projekteve të cilat synojnë përmirësimin e vazhdueshme te mjedisit dhe te përbërësve te tij . | |

**F1.O2. Mbrojtja e mjedisit nëpërmjet hartimit të planit të veprimit të zhurmave.**
**Situata e vleresuar në fund te vitit 2016:**

- Bashkia e Shkodrës, gjatë vitit 2016 në kuadër edhe të hartimit të PPV , krijoi të dhënat mbi zonat me zhurma në territorin e saj .

| Situata e synuar 2017 | Situata e synuar 2018 | Situata e synuar 2019 |
|---|---|---|
| **Hartëzimi i hotspoteve te zhurmave në qytetin e Shkodrës..** | Hartëzimi i hotspoteve te zhurmave në zonën urbane Velipojë, Rrethina | Hartëzimi i hotspoteve te zhurmave në të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër |

#### 3.1.2. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F1.O2

| Aktiviteti | Buxheti në mijë lekë |
|---|---|
| **P8.F1.O2.A1.** Krijimi i një database me pikat e nxehta të zhurmave dhe pasqyrimi i tyre në një hartë GIS. | |

**F1.O3. Promovimi i i energjisë zero në objektet publike.**
**Situata e vleresuar në fund te vitit 2016:**

- Nuk ka pasur një objektiv të qartë për promovimin e energjisë zero.

| Situata e synuar 2017 | Situata e synuar 2018 | Situata e synuar 2019 |
|---|---|---|
| **Rezultate studimore të implementimit të eficensës energjitike ne një objekt publik.** | Rezultate studimore të implementimit të eficensës energjitike ne ndriçimin publik | Rezultate studimore të implementimit të eficensës energjitike ne një banesë private |

### 3.1.3. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F1.O3

| Aktiviteti | Buxheti në mijë lekë |
|---|---|
| **P8.F1.O3.A1.**Auditim Energjetik dhe simulim i sistemeve eficente të energjisë në objektet publike, prone e Bashkisë Shkodër. | |

## 3.2. F2. Ndërgjegjesimi i banorëve nëpërmjet promovimit të politikave edukuese për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit

**F2.O1. Forcimi i pjesemarrjes publike në takimet për Vlerësimet e Ndikimit në Mjedis dhe aktivitetet në mbrojtje të tij.**
**Situata e vleresuar në fund te vitit 2016:**

- Janë realizuar me grupet e interesit 6 takime informuese/konsultuese në lidhje me VSM në kuadër të PPV

| Situata e synuar 2017 | Situata e synuar 2018 | Situata e synuar 2019 |
|---|---|---|
| **Realizimi i 4 takimeve informuese/konsultuese** | Realizimi i 4 takimeve informuese/konsultuese | Realizimi i 4 takime informuese/konsultuese |

### 3.2.1. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F2.O1

| Aktiviteti | Buxheti në mijë lekë |
|---|---|
| **P8.F2.O1.A1.** Realizimi i 4 takimeve për sensibilizimin e banorëve të Bashkisë Shkodër mbi çështjet mjedisore dhe mbrojtjen e tij. | |

**F2.O2. Bashkëpunimi me institucionet e arsimit parauniversitar mbi promovimin e zhvillimit e qëndrueshëm të mjedisit në Bashkinë Shkodër.**
**Situata e vleresuar në fund te vitit 2016:**

- Bashkia e Shkodrës, gjatë vitit 2016 nuk ka pasur objektiv të specifkuar lidhur me aktivitetet mjedisore në arsimin parauniversitar.

| Situata e synuar 2017 | Situata e synuar 2018 | Situata e synuar 2019 |
|---|---|---|
| **Realizimi i 4 takimeve në bashkëpunim me institucionet e arsimit parauniversitar për promovin e qëndrueshëm të mjedisit.** | Realizimi i 4 takimeve në bashkëpunim me institucionet e arsimit parauniversitar për promovin e qëndrueshëm të mjedisit. | Realizimi i 4 takimeve në bashkëpunim me institucionet e arsimit parauniversitar për promovin e qëndrueshëm të mjedisit. |

### 3.2.2. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F2.O2

| Aktiviteti | Buxheti në mijë lekë |
|---|---|
| **P8.F2.O2.A1.** Katër takime sensibilizuese për:<br>22 prill "Ditën e Tokës";<br>05 Qershor - Dita botërore e mjedisi;<br>22 Shtator - Dita e lëvizjes pa makina/ Qytet i pastër;<br>11 Dhjetor - Dita ndërkombëtare e maleve – Pyllëzimi. | |

## 3.3. F3. Mbrojtjen dhe përmiresimin e mjedisit ujor, të ujërave sipërfaqësore, lumenjve dhe liqenit, ujrave nëtokesore etj. nëpërmjet shfrytëzimit racional të burimeve ujore, shpërndarjen e drejtë të tyre sipas qëllimeve të përdorimit si edhe mbrojtjen e tyre nga ndotja.

**F3.O1.Bashkëpunimi me Ministrinë e Mjedisit dhe institucionet e tjera për të pasur pranë Bashkisë kadastrën elektronike të burimeve ujor.**
**Situata e vleresuar në fund te vitit 2016:**

– Në kuadër të PPV dhe informacionit të mbledhur nga Institucionet qëndrore dhe agjensitë e ndryshme ka filluar mbledhja e informacionit për të realizuar një kadastër ujore të tërritorit të Bashkisë Shkodër.

| Situata e synuar 2017 | Situata e synuar 2018 | Situata e synuar 2019 |
|---|---|---|
| **Realizimi i kadastrës ujore të Bashkisë Shkodër** | Realizimi i kadastrës ujore të Bashkisë Shkodër | Realizimi i kadastrës ujore të Bashkisë Shkodër |

### 3.3.1. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F3.O1

| Aktiviteti | Buxheti në mijë lekë |
|---|---|
| **P8.F3.O1.A1.** Mbledhja e databases/ informacionit për hartimin e kadastrës ujore. | |

**F3.O2.Pjesemarrje ne hartimin e planit te menaxhimit te burimeve ujore per basenin Drin-Bune**.
**Situata e vleresuar në fund te vitit 2016:**

– Në bashkëpunim me institucionet qëndrore si MBAU , MM etj kemi qënë pjesë e punës për hartimin e planit të menaxhimit të basenit Drin-Bunë.

| Situata e synuar 2017 | Situata e synuar 2018 | Situata e synuar 2019 |
|---|---|---|
| **Realizimi i planit te menaxhimit te ujrave te basenit ujor (Bashkia Shkoder).** | Realizimi i planit te menaxhimit te ujrave te basenit ujor (Bashkia Shkoder) | Realizimi i planit te menaxhimit te ujrave te basenit ujor (Bashkia Shkoder) |

### 3.3.2. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F3.O2

| Aktiviteti | Buxheti në mijë lekë |
|---|---|

| |
|---|
| **P8.F3.O2.A1**. Mbledhja e informacionit për përdorimin e ujrave në Bashkinë e Shkodrës në kuadër të planit të menaxhimit të Basenit Drin-Bunë. |

**F3.O3. Shfrytëzimi racional dhe i kontrolluar i burimeve nëntokësore:**
**Situata e vleresuar në fund te vitit 2016:**

- Për vitin 2016 , nuk ka pasur një objektiv specifik në këtë fushë.

| Situata e synuar 2017 | Situata e synuar 2018 | Situata e synuar 2019 |
|---|---|---|
| **Indentifikimi i pus-shpimeve në qytetin e Shkodres.** | Indentifikimi i pus-shpimeve në Nj.A Rrethina) | Indentifikimi i pus-shpimeve në Bashkinë Shkodër |
| **Identifikimi dhe evidentimi i ndotësve ujorë (familje, industri) qyteti Shkodër** | Identifikimi dhe evidentimi i ndotësve ujorë (familje, industri) NjA Rrethina | Identifikimi dhe evidentimi i ndotësve ujorë (familje, industri Bashkia Shkodër |

### 3.3.3. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F3.O3

| Aktiviteti | Buxheti në mijë lekë |
|---|---|
| **P8.F3.O3.A1.**Identifikimi dhe evidentimi i shfrytezimit te burimeve urjore nëntokësore (pus-shpimet). | |
| **P8.F3.O3.A2.**Identifikimi dhe evidentimi i ndotësve ujor (familje, industri, etj.) | |

## 3.4. F4. Administrimin e pyjeve dhe kullotave vendore si dhe menaxhimin e institucioneve në shërbim të këtij funksioni, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj. ndotja.

**F4.O1.Sigurimi i mbrojtjes për qeverisjen e qëndrueshme dhe kontrollin e miradministrimit të fondit pyjor dhe kullosor brenda territorit administrativ të bashkisë.**
**Situata e vleresuar në fund te vitit 2016:**

- Në vitin 2016 , bazuar në Ligjin nr 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", referuar ligjit specifik nr. 9385 datë 04.05.2005 "Për pyjet dhe shërbin pyjor ",i ndryshuar, administrimi i pyjeve dhe kullotave kaloi pranë Bashkisë Shkodër. Rreth 43807.6 ha pyje dhe kullota kaluan formalisht nën administrim të Bashkisë Shkodër. Bashkia Shkodër krijoi Drejtorinë e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave me një sektor të veçantë në menaxhimin e fondit pyjor/kullosor, strukturë kjo e përqëndruar në bashki. Njëkohësisht u ngrit edhe struktura për kryerjen e shërbimeve bujqësore e pyjore.
- Me fonde të buxhetit lokal, u realizua shërbimi i ruajtjes së pyjeve nga zjarri , me 15 vrojtues për një periudhe 4 mujore.
- Me fond të buxhetit lokal u realizua shërbimi i prerjes sanitare në pyjet e gështenjës dhe ky shërbim përfaqëson punimet për heqjen e gjeneratës së vjetër te materialeve pyjore dhe krijimin e kushteve për instalimin e gjeneratës së re në rrugë natyrore.
- I gjithe materiali drusor dhe i shkurreve i perfituar nga ky sherbim i shfrytezimit te pyjeve ne zonen e Pultit, gjithsej 22 m3 u furnizua shkolla e zones.
- Për realizimin e shërbimit ndaj pyjeve u blenë edhe materiale si vegla pune etj .
- Bashkia Shkodër nëpërmjet fondit specifik të deleguar brenda Buxhetit 2016 , ( vetëm për 6 punonjës), krijoi sektorin e shërbimit për pyjet pranë Drejtorisë së Shërbimeve Bujqësore e Pyjore, sektor ky me funksion menaxhimin dhe administrimin e territorit pyjor. Referuar dispozitave ligjore fondi i pagave venë në dispozicion për këtë shërbim duhet të ishte të paktën për 20 punonjës.

| Situata e synuar 2017 | Situata e synuar 2018 | Situata e synuar 2019 |
|---|---|---|
| **Realizimi i mbrojtjes se siperfaqeve pyjore/kullosore nëpërmjet një qeverisje të mirë të fondit pyjor/kullosor.**<br><br>**Administrimi i shërbimit të pyjeve/kullotave** | Realizimi i mbrojtjes se siperfaqeve pyjore/ kullosore nëpërmjet një qeverisje të mirë të fondit pyjor/kullosor.<br><br>Administrimi i shërbimit të pyjeve/kullotave | Realizimi i mbrojtjes se siperfaqeve pyjore/ kullosore nëpërmjet një qeverisje të mirë të fondit pyjor/kullosor.<br><br>Administrimi i shërbimit të pyjeve/kullotave |

### 3.4.1. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F4.O1

| Aktiviteti | Buxheti në mijë lekë |
|---|---|
| **P8.F4.O1.A1.** Mbrojtja e siperfaqeve pyjore /kullosore/sherbimi pyjor sipas mënyrës së përcaktuar në ligj. | **3,055** |
| **P8.F4.O1.A2.** Administrimi i sherbimit te pyjeve dhe kullotave ne Bashkine Shkoder. | **3,679** |

**F4.O2. Realizimi i planeve dhe shërbimeve të mbarështimit për të gjithë sipërfaqen e fondit pyjor dhe kullosor (hartimi/rishikimi) azhornimi i Regjistrit te Pyjeve dhe Kullotave, përgatitja programit të zhvillimit të sektorit pyjor.**
**Situata e vleresuar në fund te vitit 2016:**

- Bazuar në VKM nr 433/2016 për kalimin në pronësi të Bashkive të fondit pyjor e kullosor , u bënë azhornimet e sipërfaqeve pyjore ta cilatjanë me Plane dhe cilat kanë nevojë për Plane. Situata e sejcilit plan mbarështimi. Kështu rezultoi që Ekonomitë pyjore , pra e gjithë sipërfaqja e cila ishte në administrim të MM, rezulton të mos ketë Plane, pjesë e tyre janë Pyjet e Larta. NjA apo ish Komunat kanë plane Mbarështimi por janë në limitët ligjore të vlefshmërisë së tyre. Inventari i pyjeve është i pa azhornuar dhe i referohet vitit 1985

| Situata e synuar 2017 | Situata e synuar 2018 | Situata e synuar 2019 |
|---|---|---|
| **Realizimi i Rishikimi/hartimi i Planit te Menaxhimit per Shale, Postribe**<br>**Regjistrimi dhe inventarizimi i pyjeve dhe kullotave - Shale/Postrribe** | realizimi i Rishikimi/hartimi i Planit te Menaxhimit per Shosh, Pult<br>Regjistrimi dhe inventarizimi i pyjeve dhe kullotave -Shosh Pult | realizimi i Rishikimi/hartimi i Planit te Menaxhimit per Gur i Zi, rrethina, Berdice.)<br>Regjistrimi dhe inventarizimi i pyjeve dhe kullotave -Guri i Zi Rrethina Berdic |

### 3.4.2. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F4.O2

| Aktiviteti | Buxheti në mijë lekë | Kontributi i donatorëve |
|---|---|---|
| **P8.F4.O2.A1** Rishikimi/hartimi i Planit te Menaxhimit per Shale, Postribe ,(Shosh, Pult , Gur i Zi, Rrethina, Berdice) | 0 | B.B+M.M |
| **P8.F4.O2.A2** Realizimi i regjistrimit dhe inventarizimit te Pyjeve dhe kullotave bashkiake. | 0 | B.B+M.M |

**F4.O3. Rehabilitimi, pyllëzimi dhe ripyllëzimi i sipërfaqeve, të degraduara, djegura dhe rehabilitimin e kullotave nëpërmjet praktikave silvo-pastorale.Parandalimit të gërryerjes së mëtejshem të tokës pyjore dhe kullosore.**
**Situata e vleresuar në fund te vitit 2016:**

- Bashkia ka ndërhyrë me investime në ndërtim të Lerës së Ujit në zonën e Zogajve- Tarabosh. Problematika të vërejtura në semundjet , degradimi i tokës apo shpyllëzimet. Objektivat specifikë për vitin 2016 janë realizuar.

| Situata e synuar 2017 | Situata e synuar 2018 | Situata e synuar 2019 |
|---|---|---|
| **Realizimi i projektit per Rehabilitimi mjedisor/social i guroreve ne malin e taraboshit** | Ne bashkepunim me pronaret e gurorereve te fillohet rehabilitimi mjedisor | Ne bashkepunim me pronaret e gurorereve te vazhdoje rehabilitimi mjedisor. |
| **Ndertim prita ne perrenj, faqja perendimore e lumit Kir. ( Postrribe , Guri i Zi)** | Ndertim prita ne perrenj, Kaprre, Perroi i Shehu i Bardhe" etj ( Shale). | Ndertim prita ne perrenj, Sallaman, Likaj, etj ( Shosh Pult). |
| **Pyllezim ne siperfaqet pyjore ne rrethina dhe Guri i ZI** | Pyllezim ne siperfaqet pyjore ne Postrribe, Berdice | Pyllezim ne siperfaqet pyjorePult Shale Shosh |
| **Pastrimi/permiresimi i parcelave pyjore ne Rrethina, Postribe, Pult.** | Pastrimi/permiresimi i parcelave pyjore ne Shale, Shosh | Pastrimi/permiresimi i parcelave pyjore ne Guri i zi, Berdice |
| **Sinjalistike pyjore ne Rrethina, Pult Shosh** | Sinjalistike pyjore ne Shale, Postribe | Sinjalistike pyjore ne Berdice, Guri i Zi |
| **Luftimi i semundjeve dhe demtuesve ne pyje/kullota ne qytetin Rrethina, Pult Shosh** | Luftimi i semundjeve dhe demtuesve ne pyje/kullota ne ne Shale, Postribe | Luftimi i semundjeve dhe demtuesve ne pyje/kullota ne ne Berdice, Guri i Zi |
| **Zbatimi i projektit per ndertimin e leres se ujit kullota -Guri i Zi, Postribe** | Zbatimi i projektit per ndertimin e leres se ujit kullota –Shosh. | Zbatimi i projektit per ndertimin e leres se ujit kullota -Shale . |

### 3.4.3. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F4.O3

| Aktiviteti | Buxheti në mijë lekë | Kontributi i donatorëve |
|---|---|---|
| **P8.F4.O3.A1.**Hartim i projektit "Rikualifikimi mjedisor/social i guroreve ne malin e Traboshit. | **0** | 0 |
| **P8.F4.O3.A2**. Ndertim prita malore ne Postribe, Guri i zi, (Shale, Shosh, Pult) | **3000** | |
| **P8.F4.O3.A3** Pyllezim ne siperfaqet pyjore ne Rrethina dhe Guri i ZI, (Postrribe Berdice, Pult Shale Shosh) | | **FZHR** |
| **P8.F4.O3.A4.**Pastrimi/permiresimi i parcelave pyjore ne Rrethina, Postribe,( Pult, Shale, Shosh, Guri i zi, Berdice) | **1000** | |
| **P8.F4.O3.A5.**Sinjalistike pyjore ne Rrethina, Pult, Shosh, (Shale,Postribe, Guri i zi, Berdice,). | **200** | |

| | | |
|---|---|---|
| **P8.F4.O3.A6.**Luftimi i semundjeve dhe demtuesve ne pyje/kullota ne Rrethina, Pult, (Shosh, Shale, Postribe, Guri i zi, Berdice) | **500** | |
| **P8.F4.O3.A7.**Zbatimi i projektit per ndertimin e leres se ujit kullota -Guri i Zi, Postribe,( Shosh ,Shale.) | **1000** | |
| **P8.F4.O2.A2.**Realizimi i regjistrimit dhe inventarizimit te Pyjeve dhe kullotave bashkiake. | **0** | **B.B+M.M** |

## 4. Buxhetimi i programit të Mjedisit dhe Mbrojtjes së Pyjeve dhe Kullotave

5. Për realizimin e aktiviteteve/projekteve të Programit të Mjedisit dhe Mbrojtja e Pyjeve dhe Kullotave planifikohet buxheti me vlerë totale 12,434 mijë lekë ndër të cilat 38% paga dhe sigurime shoqërore, 30 % shpenzime operative dhe 32 % investime.

6. **Tabelë 1 Planifikimi për Mjedisin dhe Mbrojtjen e Pyjeve dhe Kullotave**

| Programi P8 | Paga + Sigurime | Shpenzime Operative | Subvensioni | Transferta | Investime | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Plani 2016** | 5,691 | 1,589 | 0 | 0 | 1,015 | **8,294** |
| **Plani i ndryshuar 2016** | 5,691 | 1,589 | | | 1,015 | **8,294** |
| **I pritshmi 2016-12-mujor** | 2,808 | 1,479 | | | 670 | **4,957** |
| **Plani 2017** | 4,732 | 3,702 | 0 | 0 | 4,000 | **12,434** |
| **Plani 2018** | 4,827 | 3,702 | 0 | 0 | 4,000 | **12,529** |
| **Plani 2019** | 4,924 | 4,202 | 0 | 0 | 4,000 | **13,126** |




**Grafik 1 Planifikimi i shpenzimeve për mjedisin dhe mbrojtjen e pyjeve**




Grafik 2 Burimet e financimit për financimin e programit për mjedisin dhe mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave

## 7. Projektet dhe aktivitetet e planifikuara për mjedisin dhe mbrojtjen e pyjeve

<table>
<tr><td>Nr.1</td><td>Projekti : P8.F1.O1.A1.<br>Zbatimi i objektivave mjedisore të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Shkodër</td><td>Llojet e programit : P8 Mjedisi dhe mbrojtja e Pyjeve e kullotave<br><br>Funksioni P8.F1 Zbatimin e dispozitave ligjore nëpërmjet strategjive, programeve dhe projekteve te cilat synojnë përmirësimin e vazhdueshme te mjedisit dhe te përbërësve te tij.</td></tr>
</table>

<table>
<tr><td colspan="2">a) Përshkrimi i shkurtër i projektit :</td></tr>
<tr><td colspan="2">i. Situata</td></tr>
<tr><td colspan="2">Aktualisht kemi të përfunduar raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Shkodër. Ky raport identifikon problemet mjedisore të Bashkisë Shkodër dhe paraqet politikat, projektet dhe masat e nevojshme për të ndërhyrë në këto probleme, në nivel strategjik.</td></tr>
<tr><td colspan="2">ii. Synimi i projektit</td></tr>
<tr><td colspan="2">Ruajtja e parametrave mjedisorë, zhvillimit të qëndrueshëm dhe përmirësmin e jëtës së banorëve të Bashkisë Shkodër.</td></tr>
<tr><td colspan="2">iii. Aktivitetet kryesore të projektit</td></tr>
<tr><td colspan="2">Ndjekja dhe shqyrtimi i problematikave mjedisore të bashkisë në përputhje me objektivat e Planit të Përgjithshëm Vendor.</td></tr>
<tr><td colspan="2">b) Rezultatet që prisni</td></tr>
<tr><td colspan="2">• Mbrojtja e burimeve natyrore dhe zonave të mbrojtura<br>• Mbrojtja, menaxhimi dhe përdorimi i qëndrueshëm i tokës<br>• Parandalimi i shfrytëzimit pa kriter të burimeve natyrore, me përdorimin e materialeve të ricikluesh me gjatë ndërtimit / rehabilitimit të infrastrukturës.<br>• Mbrojtja nga efektet negative mbi ujërat ( nëntokësore dhe sipërfaqësore, bregdetare dhe burimet e ujit të pijshëm).<br>• Mbrojtja e biodiversitetit (florës dhe faunës) dhe pyjeve.<br>• Ruajtja e zonave me status të veçantë mbrojtjeje, prej aktiviteteve me ndikime të konsiderueshme.<br>• Reduktimi i ndotjes së zhurmës/akustike dhe përafrimi me nivelet e rekomanduara nga BE dhe OBSH.</td></tr>
<tr><td>c) Aktoret e mundshëm</td><td>d) Kontributet e mundshme në projekt</td></tr>
<tr><td>Bashkia Shkoder<br>Ministria e Mjedisit<br>Agjensia Kombetare e Mjedisit<br>Agjensia Rajonale e Mjedisit<br>Shoqatat Mjedisore</td><td>Bashkia Shkodër</td></tr>
</table>

<table>
<tr><td colspan="8">e) Shpenzimet e llogaritura</td></tr>
<tr><td colspan="2" rowspan="2">Shpenzimet për çdo aktivitet 2017</td><td rowspan="2">Totali ( mije lekë)</td><td colspan="5">Nga kjo:</td></tr>
<tr><td>Paga</td><td>Sigurime</td><td>Operative</td><td>Transferime</td><td>Kapitale</td></tr>
<tr><td>A.1</td><td>Zbatimi i objektivave mjedisore të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Shkodër</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr>
<tr><td></td><td>Shuma</td><td>0</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr>
<tr><td colspan="2" rowspan="2">Shpenzimet për çdo aktivitet 2018</td><td rowspan="2">Totali ( mije lekë)</td><td colspan="5">Nga kjo:</td></tr>
<tr><td>Paga</td><td>Sigurime</td><td>Operative</td><td>Transferime</td><td>Kapitale</td></tr>
<tr><td>A.1</td><td>Zbatimi i objektivave mjedisore të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Shkodër</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr>
<tr><td></td><td>Shuma</td><td>0</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr>
<tr><td colspan="2" rowspan="2">Shpenzimet për çdo aktivitet 2019</td><td rowspan="2">Totali ( mije lekë)</td><td colspan="5">Nga kjo:</td></tr>
<tr><td>Paga</td><td>Sigurime</td><td>Operative</td><td>Transferime</td><td>Kapitale</td></tr>
<tr><td>A.1</td><td>Zbatimi i objektivave mjedisore të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Shkodër</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr>
<tr><td></td><td>Shuma</td><td>0</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr>
<tr><td colspan="3">f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon)<br>Janar 2017- Dhjetor 2017<br>Janar 2018- Dhjetor 2018<br>Janar 2019- Dhjetor 2019</td><td colspan="5">g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave</td></tr>
</table>

| | | |
|---|---|---|
| Nr.2 | **Projekti : P8.F1.O2.A1.** Krijimi i një database me pikat e nxehta të zhurmave dhe pasqyrimi i tyre në një hartë GIS | **Llojet e programit : P8** Mjedisi dhe mbrojtja e Pyjeve e kullotave<br><br>**Funksioni P8.F1** Zbatimin e dispozitave ligjore nepermjet strategjive, programeve dhe projekteve te cilat synojne permiresimin e vazhdueshme te mjedisit dhe te perbersve te tij. |

| | |
|---|---|
| **a) Pershkrimi i shkurter i projektit** : Mbledhja dhe organizimi i informacionit për regjitrimin e pikave të nxehtave të zhurmave për qytetin e Shkodrës | |
| **i. Situata** | |
| Nuk ekziston një hartë e Bashkisë Shkodër për nivelin e zhurmave dhe të pikave të nxehta të tyre. Nevoja për përcaktimin e zonave problematike në lidhje me nivelin e zhurmave të qytetit të Shkodrës është e domosdoshme pasi ndërhyrja apo urbanizimi i qytetit është i lidhur ngushtë me karaktetistikat akustike të qytetit. | |
| **ii. Synimi i projektit** | |
| • Në kuadër të zbatimit të ligjit Nr.9774, datë 12.7.2007 për "Vlerësimin dhe Administrimin e Zhurmave në Mjedis", NjQV-të kanë për të detyrë të drejtojnë punën për hartëzimin e zhurmave dhe indentifikimin e hotspoteve. | |
| **iii. Aktivitetet kryesore të projektit** | |
| • Krijimi i një database për nivelin e zhurmave dhe të pikave ttë nxehta dhe pasqyrimi i tyre në një hartë GIS. | |
| **b) Rezultatet që prisni** | |
| • Një hartë për nivelin e zhurmave dhe hotspoteve kryesore në qytetin e Shkodrës. | |
| **c) Aktoret e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshme në projekt** |
| Bashkia Shkoder<br>Ministria e Mjedisit<br>Agjensia Kombetare e Mjedisit<br>Agjensia Rajonale e Mjedisit<br>Shoqatat Mjedisore | Bashkia Shkoder |
| **e) Shpenzimet e llogaritura ( per cdo aktivitet te mesiperme (pika iii)** | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Shpenzimet per çdo aktivitet 2017** | | Totali (000 lek) | Nga kjo: | | |
| | | | Paga, sig | operative | kapitale |
| A1 | Krijimi i një database me pikat e nxehta të zhurmave dhe pasqyrimi i tyre në një hartë GIS | | | | |
| | **Shuma** | **0** | | | |
| **Shpenzimet per çdo aktivitet 2018** | | Totali (000 lek) | Nga kjo: | | |
| | | | Paga, sig | operative | kapitale |
| A1 | Krijimi i një database me pikat e nxehta të zhurmave dhe pasqyrimi i tyre në një hartë GIS | | | | |
| | **Shuma** | **0** | | | |
| **Shpenzimet per çdo aktivitet 2019** | | Totali (000 lek) | Nga kjo: | | |
| | | | Paga, sig | operative | kapitale |
| A1 | Krijimi i një database me pikat e nxehta të zhurmave dhe pasqyrimi i tyre në një hartë GIS | | | | |
| | **Shuma** | **0** | | | |

| | |
|---|---|
| **f) Periudha e zbatimit(kur fillon, kur perfundon)**<br>Janar 2017- Dhjetor 2017<br>Janar 2018- Dhjetor 2018<br>Janar 2019 Dhjetor 2019 | **g) Pergatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave |

| | | |
|---|---|---|
| Nr.3 | **Projekti : P8.F1.O3.A1**<br>Auditimi energjetik dhe simulimi i sistemeve efiçente të energjisë, në objektet publike, prone e bashkise Shkoder | **Llojet e programit P8.** Mjedisi dhe mbrojtja e Pyjeve e kullotave.<br><br>**Funksioni P8.F3.** Zbatimin e dispozitave ligjore nëpërmjet strategjive, programeve dhe projekteve te cilat synojnë përmirësimin e vazhdueshme te mjedisit dhe te përbërësve te tij. |

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit** : Ky projekt konsiston në vlerësimin e humbjeve energjetikeve të banesave publike dhe dhënien e zgjidhjeve eficente të simulimit të energjisë duke përdorur teknologjinë ekologjike (energjinë e rinovueshme), për plotësimin e nevojave për ngrohje, ndriçim, në reduktim maksimal të energjisë elektrike

**i. Situata**

Koncepti i "energjisë zero" në banesa nuk është përqafuar akoma nga banesat e qytetit. Në përgjithesi banesat e vjetra apo dhe ato te reja privte nuk janë të termoizoluara. Kohët e fundit ka një tendencë drejt termoizolimit të tyre, ku veçanërisht vërehen tek pallatet e reja. Vihen re shumë pak ndërtesa ku kanë filluar të përdorin panelet diellore per ngrohje apo uje te ngrohtë sanitar.
Në mënyrë të veçantë këto teknologji në objektet publike nuk janë të pranishme. Mungesa e termoizolomit ne banesa sjell humbje të mëdha të energjisë, humbejn e komfortit termik dhe kosto më e lartë për ngrohje. Përdorimi i sistemeve eficente të ngrohjes, me përdormin dhe te energjive të rinovueshme realizojme komfortin termik me nje kosto me të ulët.

**ii. Synimi il projektit**

Promovimi i "Energjisë Zero" në banesa me qëllim reduktimin e kostos për ngrohje dhe përdorimin e energjisë së rinovueshme duke zëvendësuar përdorimin e lëndëve djegëse për ngrohje.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

Auditimi energjetik dhe simulimi i sistemeve efiçente të energjisë, në shtëpinë e fëmijëve / konvikti "Safet Spahija"

**b) Rezultatet që prisni**

Studimi dhe projektim energjetik i objektit dhe nxjerrja e përfundimeve teknike në lidhje me propozimet e bëra në simulimin termik. Ky studim do të shërbeje si reference për projektim apo ndërhyrje në përmirësimin energjetik të objekteve publike.

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|
| Bashkia Shkodër<br>Ministria e Mjedisit<br>Agjensia Kombetare e Mjedisit<br>Agjensia Rajonale e Mjedisit<br>Shoqatat Mjedisore | Bashkia Shkodër |

**e) Shpenzimet e llogaritura ( per çdo aktivitet të mësipërme**

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2017** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Auditim Energjetik dhe simulim i sistemeve efiçente të energjisë në objektet publike , pronë e Bashkisë Shkodër. | 0 | | | | | |
| | **Shuma** | **0** | | | | | |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2018** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Rezultate studimore të implementimit të eficensës energjitike në ndriçimin publik | 0 | | | | | |
| | **Shuma** | **0** | | | | | |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2019** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Rezultate studimore të implementimit të eficensës energjitike ne një banesë private | 0 | | | | | |
| | **Shuma** | **0** | | | | | |

| | |
|---|---|
| **f) Periudha e zbatimit**<br>janar 2017 – dhjetor 2017<br>janar 2018 – dhjetor 2018<br>janar 2019 – dhjetor 2019 | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave/Drejtoria e Sherbimeve bujqesore e pyjore. |

| | | |
|---|---|---|
| Nr.4 | **Projekti : P8.F2.O1.A1.**<br>Realizimi i 4 takimeve ndërgjegjësuese për ruajtjen e mjedisit | **Llojet e programit: P8** Mjedisi dhe mbrojtja e Pyjeve e kullotave<br><br>**Funksioni P8.F1** Ndërgjegjësimi i banorëve nëpërmjet promovimit të politikave edukuese për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit. |

**a) Pershkrimi i shkurter i projektit** Pjesemarrje e komunitetit /ndergjegjesimi i banoreve nepermjet promovimit te politikave edukuese per ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit.

**i. Situata**

Në kuadër të Planit të Përgjishëm Vendor, Bashkia Shkodër ka hartuar raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor. Në zbatim të ligjit për informimin e publikut, mbrojtjes së mjedisit dhe vlerësimit të ndkimit në mjedis bashkia ka zhvilliar dëgjesa publike në kuadër të informimit dhe pjesmarrjes në hartimin e VSM te planit. Gjithashtu bashkia ofron kushtet e nevojshme për realizim e degjesave publike për VNM të projekteve të ndryshme.

**ii. Synimi i projektit**

Qëllimi themelor i ketij projekti është plotësimi i detyrimeve kushtetuese ndaj shtetasve te Bashkise Shkodër që ata të jenë të informuar për gjendjen e mjedisit, që mjedisi të mbrohet e të administrohet sipas kërkesave të parimit të zhvillimit të qëndrueshëm dhe që ata të jetojnë në një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për vete dhe për brezat e ardhshëm. Në këtë mënyrë, ai nxit përafrime të dukshme me legjislacionin komunitar për çështjet e mjedisit, i cili, gjithashtu, synon të kontribuojë për ruajtjen, mbrojtjen dhe për përmirësimin e cilësisë së mjedisit, si dhe për mbrojtjen e shëndetit njerëzor.
E drejta për informim për çështjet e mjedisit është bazike për të arritur një qëllim të përbashkët që është mbrojtja e mjedisit dhe krijimi i kushteve mjedisore të shëndetshme për çdo individ.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

Realizmi i katër takimeve informuese në kuadër të mbrojtjes së mjedisit.

**b) Rezultatet që prisni**

Informimin e publikut për projektin e propozuar dhe marrjen e mendimit të tij në fazën e përcaktimit të çështjeve që do të trajtohen, shoqëruar me sqarimet për procedurën në zbatim;
b) Informimin e publikut për komunikimin me zhvilluesin për çështjet që duhet të trajtohen në raportin e vleresimit mjedisor por jo vetem
c) Informimin dhe përfshirjen e publikut për organizimin dhe realizimin e dëgjesës publike;
d) Informimin e publikut dhe marrjen e mendimit të tij nga institucione te tjera në fazën e shqyrtimit dhe miratimit të Deklaratës Mjedisore;
dh) Informimin e publikut gjatë monitorimit të ndikimeve në mjedis të projektit.

| **c) Aktoret e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|
| Bashkia Shkoder<br>Ministria e Mjedisit<br>Agjensia Kombetare e Mjedisit<br>Agjensia Rajonale e Mjedisit<br>Shoqatat Mjedisore | Bashkia Shkoder |

**e) Shpenzimet e llogaritura**

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2017** | | Totali ( mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurim e | Operativ e | Transferi me | Kapitale |
| A.1 | Realizimi i 4 takimeve | 0 | | | | | |
| | **Shuma** | **0** | | | | | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2018** | | Totali ( mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Sigurim e | Operativ e | Transferi me | Kapitale |
| A.1 | Realizimi i 4 takimeve | 0 | | | | | |
| | **Shuma** | **0** | | | | | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2019** | | Totali ( mije | Nga kjo: | | | | |

| | | lekë) | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A.1 | Realizimi i 4 takimeve | 0 | | | | | |
| | **Shuma** | **0** | | | | | |

| | |
|---|---|
| **f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon)**<br>janar 2017 – dhjetor 2017<br>janar 2018 – dhjetor 2018<br>janar 2019 – dhjetor 2019 | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave/Drejtoria e Sherbimeve bujqesore e pyjore. |

| | | |
|---|---|---|
| Nr.5 | **Projekti:P8.F2.O2.A1.**<br>Takimesensibilizuese më:<br>22 prill "Dita e Tokës",<br>Takim sencibilizues në 05 qershor – Dita Botërore e Mjedisit<br>Aktivitet sencibilizues në 22shtator – Dita e lëvizjes pa makina/ Qytet i pastër<br>Takim sencibilizues në 11 dhjetor<br>Dita ndërkombëtare e maleve. Pyllëzimi | **Llojet e programit: P8** Mjedisi dhe mbrojtja e Pyjeve e kullotave<br><br>**Funksioni P8.F1** Ndërgjegjësimi i banorëve nëpërmjet promovimit të politikave edukuese për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit. |

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit :**
Organizimi i aktiviteteve informues dhe sencibilizues me nxënësit e shkollave tetëvjeçare në kuadër të ruajtjes së mjedisit. Nxënësit do të pajisen dhe me fletëpalosje informuese dhe do të nxiten të marrin pjesë në aktivitete konkrete në mbrojtje të mjedisit si mbjellja e pemeve pranë shkollës , sheshit, lulishtes së tyre.

**i. Situata**

Bashkia Shkodër ka zhvilluar takime apo aktivitete sencibilizuese në kudër të ruajtjes dhe mbrojtjes së mjedisit. Në kuadër të këtyre aktiviteteve ka bashkëpunuar edhe me shoqatat mjedisore duke kontribuar në ndërgjegjësimin qytetar në mbrojtje të mjedisit. Ajo siguron dhe zhvillimin e dëgjësave publike të Vlerësimeve të ndikimit në mjedis të projekteve që kërkojnë VNM. Mungojnë takimet apo aktivitetet me brezin e ri (nxënësit e shkollave) për ruajtjen e promovimin e një mjedisit pastër

**ii. Synimi i projektit**

Në kuadër të ligjit për vetëqeverisjen vendore ,(neni 26 pika C. Zhvillimin e aktiviteteve edukuese dhe promovuese, në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e mjedisit) bashkia Shkodër zhvillon këto aktivitete në kuadër të ndërgjegjësimit të brezit të ri në ruajtjen e mjedisit si një aset apo e mirë e përbashkët për ne dhe brezat e ardhshëm, duke zhvilluar gjithnjë e më shumë konceptin e zhvillimit të qëndrueshëm.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

Takim sensibilizues në 22 prill "Dita e Tokës".
Takim sensibilizues në 05 qershor – Dita Botërore e Mjedisit,
Aktivitet sensibilizues në 22 shtator – Dita e lëvizjes pa makina/ Qytet i pastër.
Takim sensibilizues në 11 dhjetor - Dita ndërkombëtare e maleve. Pyllëzimi

**b) Rezultatet që prisni**

Ndërgjegjgësimi dhe angazhimi i brezit të ri në ruajtjen e mjedisit.

| c) Aktoret e mundshëm (grupet që lidhen me projektin dhe që ndikohen) | d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht etj.) |
|---|---|
| Bashkia Shkoder<br>Ministria e Mjedisit<br>Agjensia Kombetare e Mjedisit<br>Agjensia Rajonale e Mjedisit<br>Shoqatat Mjedisore | Bashkia Shkodër |

**e) Shpenzimet e llogaritura**

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2017** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Takim sensibilizues me:<br>– 22 prill "Dita e Tokës".<br>Takim sensibilizues në 05 qershor – Dita Botërore e Mjedisit,<br>Aktivitet sensibilizues në 22 shtator – Dita e lëvizjes pa makina/ Qytet i pastër.<br>– Takim sensibilizues në 11 dhjetor - Dita ndërkombëtare e maleve. Pyllëzimi | 0 | | | | | |
| | **Shuma** | **0** | | | | | |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2018** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Takim sensibilizues me:<br>– 22 prill "Dita e Tokës".<br>Takim sensibilizues në 05 qershor – Dita Botërore e Mjedisit, | 0 | | | 0 | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Aktivitet sensibilizues në 22 shtator – Dita e lëvizjes pa makina/ Qytet i pastër.<br>– Takim sensibilizues në 11 dhjetor - Dita ndërkombëtare e maleve.<br>Pyllëzimi | | | | | | |
| | **Shuma** | **0** | | | 0 | | |

| Shpenzimet për çdo aktivitet 2019 | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Takim sensibilizues me:<br>– 22 prill "Dita e Tokës".<br>Takim sensibilizues në 05 qershor – Dita Botërore e Mjedisit,<br>Aktivitet sensibilizues në 22 shtator – Dita e lëvizjes pa makina/ Qytet i pastër.<br>– Takim sensibilizues në 11 dhjetor - Dita ndërkombëtare e maleve.<br>Pyllëzimi | 0 | | | | | |
| | **Shuma** | **0** | | | | | |

| **f) Periudha e zbatimit** | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:** |
|---|---|
| janar 2017 – dhjetor 2017<br>janar 2018 – dhjetor 2018<br>janar 2019 – dhjetor 2019 | Drejtoria e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave/Drejtoria e Sherbimeve bujqesore e pyjore. |

| Nr.6 | **Projekti : P8.F3.O1.A1** Mbledhja e database/informacionit për hartimin e kadastrës ujore. | **Llojet e programit P8.** Mjedisi dhe mbrojtja e Pyjeve e kullotave.<br><br>**Funksioni P8.F3.**. Mbrojtjen dhe permiresimin e mjedisit ujor, te ujerave siperfaqesore dhe nëntokësore, lumenjve dhe liqenit, shfrytëzimi racional i tyre. |
|---|---|---|

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:** Mbledhja e databases/informacionit për hartimin e kadastres ujore në Bashkinë Shkodër.

**i. Situata**

Hidrogjeologjia e Shkodrës përfaqësohet nga pellgu ujëmbajtës i zonës së Shkodrës. Sistemi ujor i Liqenit të Shkodrës, Lumit Buna dhe Drin është pjesë e pellgut ujëmbledhës të Drinit dhe Alpeve Shqiptare. Ujrat nëntokësore nga depozitimet e reja përbëjnë potencialin ujëmbajtës të Shkodrës, zonë e cila është furnizues kryesor me ujë të pijshëm të qytetit të Shkodrës dhe fshatrat përreth tij.
Ka shumë studime të kryera në këtë fushë jo vetëm nga institucione shtetërore si ministrte përkatëse por edhe institutet si ai gjeologjik, por edhe organizata të ndryshme. Mbledhja dhe krijimi i nje databaze dhe pasaportave teknike per ujrat dhe cilesine e tyre, mireorganizimi i ketyre te dhenave per kete pellg ujembledhës do të shërbente për një menaxhim më të mirë te tij dhe problematikes qe krijohet.

**ii. Synimi il projektit**

- Të përmirësohët qeverisja vendore dhe ofrimi i shërbimeve ndaj qytetarëve.
- Qëllimi themelor i këtij projekti është pasja e një database/ nformacioni jo vetem ne hardcopy por edhe në format dëg, apo gis per te gjithe pellgun ujembledhes.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

1. Mbledhja e informacionit të nevojshëm për hartimin e databases për pellgun ujëmbledhes të sistemit ujor të Shkodrës. ( Lumi Drin, Buna , Liqeni i Shkodrës), si dhe burimeve te tjera nentokësore.

**b) Rezultatet që prisni ( shërbimet apo produktet që u dorëzoni përfituesve të synuar)**

- Informacioni që do të mblidhet në vazhdimësi do të jete burim per planifikimin dhe menaxhimin e burimeve ujore ne pergjithesi si edhe per parandalimin e situatave qe krijohen ne raste të vecanta.

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|
| Bashkia Shkodër<br>Ministria e Mjedisit<br>Agjensia Kombetare e Mjedisit<br>Agjensia Rajonale e Mjedisit<br>Shoqatat Mjedisore | Bashkia Shkodër |

**e) Shpenzimet e llogaritura ( per çdo aktivitet të mësipërme (pika iii)**

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2017** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigu rime | Operative | Transf erime | Kapita le |
| A. 1 | Mbledhja e informacionit të nevojshëm për hartimin e databases për pellgun ujëmbledhes të sistemit ujor të Shkodrës | 0 | | | | | 0 |
| | **Shuma** | **0** | | | | | **0** |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2018** | | Totali ( mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigu rime | Operative | Transf erime | Kapita le |
| A. 1 | Mbledhja e informacionit të nevojshëm për hartimin e databases për pellgun ujëmbledhes të sistemit ujor të Shkodrës | 0 | | | 0 | | |
| | **Shuma** | **0** | | | 0 | | |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2019** | | Totali ( mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurim e | Opera tive | Transf erime | Kapita le |
| A. 1 | Mbledhja e informacionit të nevojshëm për hartimin e databases për pellgun ujëmbledhes të sistemit ujor të Shkodrës | 0 | | | | | |
| | **Shuma** | **0** | | | | | |

| **f) Periudha e zbatimit**<br>janar 2017 – dhjetor 2017<br>janar 2018 – dhjetor 2018<br>janar 2019 – dhjetor 2019 | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave/Drejtoria e Sherbimeve bujqesore e pyjore. |
|---|---|

| | | |
|---|---|---|
| Nr.7 | **Projekti : P8.F3.O2.A1.**<br>Mbledhja ( specifikimi) i databases/informacionit për përdorimin e ujrave ne Bashkine Shkodër | **Llojet e programit P8.** Mjedisi dhe mbrojtja e Pyjeve e kullotave.<br><br>**Funksioni P8.F3.** Mbrojtjen dhe permiresimin e mjedisit ujor, te ujerave siperfaqesore dhe nentokësore, lumenjve dhe liqenit, perdorimi racional i tyre. |

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit**
Mbledhja (specifikimi) i informacionit per ndërtimin e database të perdorimit të ujërave në Bashkinë Shkodër.

**i. Situata**

Mungesa e një kadastre elektronike për situatën ujore ( Pellgu Ujëmbledhës ) në përgjithësi dhe atë të ujrave të përdorura të Bashkisë Shkodër në veçanti, përbën mangësi për një menaxhim sa më të mirë të ujrave.
Përcaktimi qartë i problematikave si :

- Ujërat e ndotura urbane, të shkarkuara direkt në ujërat sipërfaqësore pa u trajtuar;
- Ujërat e ndotura industriale dhe ujërat e shkarkuara nga sektori i bujqësisë.
- Ndotja historike industriale gjithashtu vazhdon të mbetet një faktor konstant në prishjen e cilësisë së ujërave sipërfaqësore /nëntokësore.
- Ndotja e ujërave sipërfaqësore nga veprimtaritë bujqësore dhe blegtorale është një dukuri që po shtohet krahas zhvillimeve në këtë sektor. Megjithatë, aktualisht nuk ekziston një program monitorimi apo vlerësimi për potencialin ndotës në trupat ujore nga ky sektor.
- Shoqërimi i këtyre problematikave me material elektronik të saktë.

**ii. Synimi i projektit**

Të përmirësohet kontrolli mbi territorin për një planifikim më të mirë të përdorimit të resursëvë natyrore dhe mbrojtjes së tyre
Qëllimi themelor i ketij projekti është për të patur një database/i nformacioni jo vetëm ne hardcopy por edhe në format Dëg, apo Gis për të gjithë Bashkinë e Shkodrës ,që të shërbejë si burim për hartimin e planit të menaxhimit të pellgut ujëmbledhës Drin-Bunë.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

Mbledhja e informacionit të nevojshem dhe përdorimi i tij në funksion të orjentimit të ndërhyrjeve.
Koordinimi i informacionit të mbledhur me Ministrinë e Mjedisit si aktori kryesor në administrimin e ujrave dhe realizimin e Planit të menaxhimit të pellgut ujëmbledhës të lumit Drin – Bunë.

**b) Rezultatet që prisni**

Informacioni që do të mblidhet në vazhdimësi do te jetë burim për

- planifikimin dhe menaxhimin e burimeve ujore në pergjithësi .
- planifikimi për parandalimin e situatave që krijohen në raste të veçanta.

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|
| Bashkia Shkodër<br>Ministria e Mjedisit<br>Agjensia Kombetare e Mjedisit<br>Agjensia Rajonale e Mjedisit<br>Shoqatat Mjedisore | Bashkia Shkoder |

**e) Shpenzimet e llogaritura ( per cdo aktivitet të mësiperm (pika iii)**

| **Shpenzimet për çdo aktivitet** | | Totali (000 lek) | Nga kjo: | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga, sig | operative | Kapitale |
| | Mbledhja e informacionit të nevojshem dhe përdorimi i tij në funksion të orjentimit të ndërhyrjeve | | | | |
| | Koordinimi i informacionit të mbledhur me Ministrinë e Mjedisit | | | | |
| | Shuma | 0 | | | |

| **f) Periudha e zbatimit(kur fillon, kur përfundon)** | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:** |
|---|---|
| Janar – Dhjetor 2017<br>Janar – Dhjetor 2018<br>Janar – Dhjetor 2019 | Drejtoria e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave |

| | | |
|---|---|---|
| Nr.8 | **Projekti : P8.F3.O3.A1.**<br>Identifikimi dhe evidentimi i shfrytezimit të burimeve ujore nëntokësore(pus-shpime) Qyteti Shkoder | **Llojet e programit P8.** Mjedisi dhe mbrojtja e Pyjeve e kullotave.<br><br>**Funksioni P8.F3.** Mbrojtjen dhe permiresimin e mjedisit ujor, te ujerave siperfaqesore dhe nëntokësore, lumenjve dhe liqenit, shfrytëzimi racional i tyre. |

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit**

Identifikimi dhe evidentimi i perdoruesëve (familjarë dhe atyre për qellime ekonomike) të Burimeve Ujore Nëntokësore (pus-shpime)

**i. Situata**

Mos identifikimi dhe regjistrimi i te gjithë perdorueve te burimeve ujore nëntokësore , përbën një mungesë të përdorimit sa më të mirë dhë racional të ujërave në Bashkinë Shkodër.
Përcaktimi qartë i problematikave si:

- Mos respektim i legjislacionit ne fuqi mbi përdorimin dhe shfrytezimin e burimeve ujore nëntokësore.
- Mos respektim i standarteve teknike te ndërtimit të tyre .
- Impakt negativ ne shëndetin e njeriut , si pasojë e mosrespektimit të kushteve të mirëmbajtjes së tyre(klorinimi).
- Mos mbledhja e tarifës ujore e përcaktuar me ligjë, si një e ardhur e rëndësishme ne Bashkinë Shkodër.
- Ndotja historike industriale gjithashtu vazhdon të mbetet një faktor konstant në prishjen e cilësisë së ujërave sipërfaqësore /nëntokësore..

Identifikimi dhe shoqërimi i këtyre problematikave me material elektronik të saktë.

**ii. Synimi i projektit**

- Të përmirësohet kontrolli mbi territorin për një planifikim më të mirë të përdorimit të burimeve natyrore dhe mbrojtjes së tyre
- Qëllimi themelor i ketij projekti është për të patur një databazë nformacioni jo vetëm ne hardcopy por edhe në format Dëg, apo Gis për të gjithë Bashkinë e Shkodrës .

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

1. Mbledhja e informacionit të nevojshem dhe përdorimi i tij në funksion të orjentimit të ndërhyrjeve.
   Identifikimi dhe regjistrimi i te gjithë burimeve ujore nëntokësore në Bashkinë Shkoder.
2. Koordinimi i informacionit të mbledhur me drejtoritë e linjës në Bashkinë Shkodër dhe institucionet e tjera që kanë të bëjnë me administrimin e ujërave.

**b) Rezultatet që prisni**

Informacioni që do të mblidhet në vazhdimësi do te jetë burim për

- planifikimin dhe menaxhimin e burimeve ujore nëntokësore në pergjithësi .
- planifikimi për parandalimin e situatave që krijohen në raste të veçanta.

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|
| Bashkia Shkodër<br>Ministria e Mjedisit<br>Agjensia Kombetare e Mjedisit<br>Agjensia Rajonale e Mjedisit<br>Shoqatat e Përdoruesve të Ujit | Bashkia Shkoder |

**e) Shpenzimet e llogaritura**

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2017** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Siguri me | Operati ve | Transfer ime | Kapit ale |
| A.1 | Identifikimi dhe evidentimi i shfrytezimit të burimeve ujore nëntokësore(pus-shpime) Qyteti Shkoder | 0 | | | | | |
| | **Shuma** | **0** | | | | | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2018** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Siguri me | Operati ve | Transfer ime | Kapit ale |
| A.1 | Identifikimi dhe evidentimi i shfrytezimit të burimeve ujore nëntokësore(pus-shpime) NJA Rrethina | 0 | | | | | |
| | **Shuma** | **0** | | | | | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2019** | | Totali | Nga kjo: | | | | |

| | | (mije lekë) | Paga | Siguri me | Operati ve | Transfer ime | Kapit ale |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A.1 | Identifikimi dhe evidentimi i shfrytezimit të burimeve ujore nëntokësore(pus-shpime) Bashkia Shkoder | 0 | | | | | |
| | **Shuma** | **0** | | | | | |

| | |
|---|---|
| **f) Periudha e zbatimit**<br>janar 2017 – dhjetor 2017<br>janar 2018 – dhjetor 2018<br>janar 2019 – dhjetor 2019 | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave/Drejtoria e Sherbimeve bujqesore e pyjore. |

| | | |
|---|---|---|
| Nr.9 | **Projekti : P8.F3.O3.A2.**<br>Identifikimi dhe Evidentimi i Ndotësve Ujorë (familjarë dhe indutrial) Bashkia Shkodër | **Llojet e programit P8.** Mjedisi dhe mbrojtja e Pyjeve e kullotave.<br><br>**Funksioni P8.F3.** Mbrojtjen dhe permiresimin e mjedisit ujor, te ujerave siperfaqesore dhe nëntokësore, lumenjve dhe liqenit, shfrytëzimin racional , shpërndarjen e drejtë sipas qellimeve të përdorimit, si dhe mbrojtjen e tyre. |

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit**

Mbledhja (specifikimi) i databases/informacionit për identifikimin e ndotësve ujorë.

**i. Situata**

Ujërat e ndotura urbane janë të gjtha ujërat e përdorura që përmbajnë ndotës të ndryshëm . Këto ujëra përmbajnë lëndë të rrezikshme të patretshme (mbeturina ushqimesh, letra, qese plasmasi etj,), lëndë koloidale dhe të tretshme, si dhe një numër të madh bakteresh patogjene të rrezikshme për shëndetin e njeriut.

Përcaktimi qartë i problematikave si:

- Shkarkimi i mbetjeve të lëngëta urbane, bujqësore dhe industriale pa asnjë lloj trajtimi paraprak janë burimi kryesor i ndotjes së ujërave siperfaqësore.
- Levizja e shpejtë demografike e këtyre viteve drejt zonave urbane eshte shoqëruar me rritjen e ndotjes në mjediset ujore.
- Mungesa e një impianti për trajtimin e ujëravë të ndotura për qytetin e Shkodrës.
- Lëvizja e ujërave nëntokësore drejt siperfaqes së tokës dhe përzierja e tyre me ujërat e bardha.
- Ndotja e ujërave sipërfaqësore nga veprimtaritë bujqësore dhe blegtorale është një dukuri që po shtohet krahas zhvillimeve në këtë sektor. Megjithatë, aktualisht nuk ekziston një program monitorimi apo vlerësimi për potencialin ndotës në trupat ujore nga ky sektor.

Identifikimi dhe shoqërimi i këtyre problematikave me material elektronik të saktë.

**ii. Synimi i projektit**

- Të përmirësohet kontrolli mbi territorin për një planifikim më të mirë të përdorimit të resursëvë natyrore dhe mbrojtjes së tyre
- Qëllimi themelor i ketij projekti është për të patur një database/i nformacioni mbi ndotësit ujore (familjar dhe industrial) jo vetëm ne hardcopy por edhe në format dëg, apo gis për të gjithë Bashkinë e Shkodrës .

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

1. Identifikimi i faktoreve shoqeror dhe natyror te ndotjes së ujërave Evidentimi dhe regjistrimi i burimeve te ndotjes në një database.
2. Përdorimi i informacionit të mbledhur në funksion të orientimit të ndërhyrjes.
3. Koordinimi i informacionit të mbledhur me drejtoritë e linjës në Bashkinë Shkodër , si dhe me institucionet e tjera që kanë të bëjnë më administrimin e ujërave.

**b) Rezultatet që prisni**

Informacioni që do të mblidhet në vazhdimësi do te jetë burim për

- planifikimin dhe menaxhimin e burimeve ujore në pergjithësi .
- planifikimi për parandalimin e situatave që krijohen në raste të veçanta.

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|
| Bashkia Shkodër<br>Ministria e Mjedisit<br>Agjensia Kombetare e Mjedisit<br>Agjensia Rajonale e Mjedisit<br>Shoqatat Mjedisore<br>Shoqatat e përdoruesve të ujit | Bashkia Shkoder |

**e) Shpenzimet e llogaritura**

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2017** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Identifikimi dhe Evidentimi i Ndotësve Ujorë (familjarë dhe indutrial) Qyteti Shkoder | 0 | | | | | |
| | **Shuma** | **0** | | | | | |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2018** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Identifikimi dhe Evidentimi i Ndotësve Ujorë (familjarë dhe indutrial) NJA Rrethina | 0 | | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **Shuma** | **0** | | | | | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2019** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Sigurim e | Operativ e | Transferi me | Kapital e |
| A.1 | Identifikimi dhe Evidentimi i Ndotësve Ujorë (familjarë dhe indutrial) Bashkia Shkoder | 0 | | | | | |
| | **Shuma** | **0** | | | | | |

| | |
|---|---|
| **f) Periudha e zbatimit**<br>janar 2017 – dhjetor 2017<br>janar 2018 – dhjetor 2018<br>janar 2019 – dhjetor 2019 | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave/Drejtoria e Sherbimeve bujqesore e pyjore. |

| | | |
|---|---|---|
| Nr.10. | **Projekti P8.F4.O1.A1:**<br>Mbrojtje e Siperfaqeve pyjore /kullosore / Sherbimi pyjo**r** | **Llojet e programit:P8** Mjedisi dhe mbrojtja e Pyjeve e kullotave.<br><br>**Funksioni P8.F4:** Administrimin e pyjeve dhe kullotave vendore si dhe menaxhimin e institucioneve ne sherbim te ketij funksioni sipas menyres se percaktuar me ligj |

**a) Pershkrimi i shkurter i projektit:** Mbrojtje e siperfaqeve pyjore/kullosore

**i. Situata**

1.Mbrojtja dhe Administrimi i Pyjeve /Kullotave kalon si veprimtari e Njesise se Qeverisjes Vendore- Bashkia Shkoder nepermjet Ligjit nr 139/2015 “ Per veteqeverisjen vendore”. Realizimi i sherbimit te Mbrojtjes se Pyjeve /kullotave bazohet ne Ligin nr 9385/2005 ( i ndryshuar) “ Per Pyjet dhe Sherbimin pyjor “ neni 20, si edhe ne VKM nr 1080/2010 “ Per rregullat per parandalimin dhe shuarjen e zjarreve ne pyje dhe kullota, si edhe krijimin e njesive vullnetare te shuarjes se zjarreve.
Rritja natyrore e pyjeve shoqerohet me rritjen dhe zhvillimin e kurores se drureve e cila ne 80-90% te saj eshte e pa krasitur . Kjo shoqerohet me rritjen dhe zhvillimin e shkurreve hijedashese te cilat se bashku me kurorat e pa krasitura krijojne nje shtrese drunore gjysem te njome dhe gjysem te thate e cila perben rrezik potencial per djegien nga zjarret e mundeshme. Keshtu nga viti 1993 deri ne 2011 vetem ne malin e Taraboshit jane djegur mbi 200 ha pyll, madje pjesa me e bukur e tij. Djegiet asnjehere nuk kane ardhur si zjarre te rastesishme por kane qene zjarrvenie te qellimshme. Nisur edhe nga ndryshimet klimatike te cilat jane shoqeruar me rrite te temperaturave , por edhe me thatesire , mbrojtja e siperfaqes pyjore/ kullosore eshte nje domosdoshmeri.
Referuar Vendimit te mesiperm te Keshillit te Ministrave ku shprehimisht jane te paraqitura detyrat : “Organizojnë sistemin e vrojtim-sinjalizimit, i cili funksionon gjatë gjithë vitit në shkallë të ndryshme gatishmërie, në varësi të sezonit të zjarreve.
Organizojnë, për shuarjen e zjarreve dhe eliminimin e pasojave të tyre, njësitë vullnetare të shuarjes së zjarreve (NJVSHZ), me 5-15 vullnetarë, të cilët veprojnë gjatë periudhës 1 maj-15tetor, për pyjet në pronësi të qeverisjes qendrore”,
Bashkia do te caktoje 15 punonjës/vrojtues me kontrate te perkohshme per nje periudhe 5 mujore ne zonat pyjore NjA Postribe, NjA Guri i Zi, Nj A Pult Nj aShale etj Pikerisht, keto jane zonat, te cilat kane mundesine me te madhe te rrezikshmerise nga zjarret.
Gjithashtu ne zbatim te dispozitave te mesiperme per rastet e shuarjes se zjarreve masive, nevojiten punonjes te perkohshem propozohet te jete ne dispozicion nje fond per sherbimin e perkohshem , per shuarje zjarri cili planifikohet si honorar lek/ore te sherbimit te kryer.Llogaritet qe honorari te jete 1835 lek/ore sherbimi te kryer per person.
2. Ne kuader te mbrojtjes se pyjeve/kullotave dhe sherbimit ndaj tyre Bashkia Shkoder planifikon te kryeje Sherbimin e Shfrytëzimit tepyjeve ne zonen e Pultit, Shales dhe Shoshit. Ky sherbim përfaqëson punimet për heqjen e gjeneratës së vjetër te materialeve pyjore dhe krijimin e kushteve për instalimin e gjeneratës së re në rrugë natyrore, gjatë fazave të prerjeve, ose me pyllëzime artificiale për llojet që trajtohen, vlerësimin ekonomik të materialit drusor të përfituar nga ky shfrytezim gjithnje sipas percaktimeve te bera ne dispozitat ligjore ne kuader edhe te Ligjit nr 5/2016 “ Per shpalljen e moratoriumit ne pyje ne RSH” i gjithe materiali drusor dhe i shkurreve i perfituar nga ky sherbim i shfrytezimit te pyjeve ne zonen e Pultit, Shales dhe Shoshit do te grumbullohet, matet dhe magazinohet. Perdorimi i ketij materiali drusor do te sherbeje per te furnizuar shkollat e arsimit 9 vjecar te cilat ndodhen ne Bashkine Shkoder.
Fondi i vene ne dispozicion per kete aktivitet eshte ne vleren 760.000 lek.

**ii. Synimi i projektit**

- Nepermjet ketij aktiviteti do te arrihet te mbrohet siperfaqja pyjore/kullosore nga zjarret te cilat ne te shumten e rasteve jane zjarrvenie te qellimshme.
- Nepermjet vrojtuesve arrihet te njoftohet ne kohe per rastet e zjarreve dhe parandalohen keto zjarrvenie.
- Njekohesisht planifikimi i punonjesve te perkohshem eshte i nevojshem qe ne raste te zjarreve massive te jete mundesia qe te merren punonjes shtese per shuarjen e ketyre zjarreve dhe shpetimin e pyjeve/kullotave nga djegiet.
- Nje aspekt tjeter i mbrojtjes se pyjeve eshte edhe sherbimi i pastrimit te tyre nga drure te thate apo shkurre te krijuara ne menyre natyrale. Ofrimi i sherbimit per pastrimin e pyjeve ne NjA Pult , Shale dhe Shosh do te beje qe te mbrohet kjo siperfaqe e rendesishme pyjore.

**iii. Aktivitetet kryesorete projektit**

1. Sherbimi i mbrojtjes se pyjeve/kullotave nga zjarri.
2. Sherbimi i pastrimit te pyjeve ne NJA Pult , Shale dhe Shosh nepermjet heqjes se materialeve drusore te formuara ne menyre natyrore.

**b) Rezultatet qe prisni**

- Ruajtja dhe mbrojtja e pyjeve/ kullotave nga djegia. Zjarret jane nje nga demtuesit kryesore te pyjeve/kullotave. Nepermjet ketij sherbimi do te arrijme qe te mbrojme pyjet nga demtimi duke i konsideruar keto pyjet/kullotat si nje pasuri e rendesishme ne sherbim te komunitetit te Shkodres dhe me gjere.
- Pastrimi i pyjeve NjA Pult Shale dhe Shosh si edhe perfitimi i materialit drusor i cili do te vleresohet/matet dhe magazinohet per tu pergorur per ngrohje nga shkollat 9 vjecare te Bashkise Shkoder.

| c) Aktoret e mundshem | d) Kontributet e mundshme ne projekt |
|---|---|
| Komuniteti i zonave<br>Shoqatat e pujeve<br>Shoqatat mjedisore | Bashkia Shkoder<br>Shoqatat e pyjeve<br>Shoqatat Mjedisore<br>Vullnetare |

| | |
|---|---|
| **f) Periudha e zbatimit(kur fillon, kur perfundon)**<br>Janar 2017- Dhjetor 2017<br>Janar 2018- Dhjetor 2018<br>Janar 2019- Dhjetor 2019 | **g) Pergatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave/ Drejtoria e Sherbimeve Bujqesore e Pyjore |

| | | |
|---|---|---|
| Nr.11 | **Projekti : P8.F4.O1.A2.** Administrimi i shërbimit të pyjeve dhe kullotave në Bashkinë Shkodër | **Llojet e programit : Llojet e programit : P8** Mjedisi dhe mbrojtja e Pyjeve e kullotave.<br><br>**Funksioni P8.F4. :** Administrimin e pyjeve dhe kullotave vendore si dhe menaxhimin e institucioneve në sherbim te ketij funksioni sipas menyrës së përcaktuar me ligj. |

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:** Administrimi i shërbimit të pyjeve dhe kullotave në Bashkinë Shkodër

**i. Situata**

Administrimi i Pyjeve /Kullotave ka kaluar si veprimtari e Njësisë së Qeverisjes Vendore – Bashkia Shkodër. Për realizimin e këtij shërbimi përveç strukturës së brendshme të Bashkisë Shkodër prej një Drejtorie me 2 sektorë dhe 4 zyra me një personel prej 7 personash, për vitin 2016 nga Buxheti i Shtetit, miratuar me Ligjin nr 147/2015 " Për buxhetin e vitit 2016" , për shërbimin e administrimit të pyjeve parashikon :
Punonjës Administrimi i pyjeve/Shërbimi pyjor

Struktura administrative përgjegjëse për pyjet dhe kullotat, referuar ligjit organik , evidenton dhe inspekton fondin pyjor e kullosor nderhyrjet qe kryhen në kete fond , zjarret e rënë në pyjet dhe kullotat që administrojnë apo kanë në pronësi dhe raportojnë të dhënat statistikore, në përputhje me kriteret e vendosur në përcaktimet e dispozitave ligjore.
Shërbimi Pyjor organizohet e vepron sipas parimeve të profesionalizmit, pavarësisë, transparencës, shërbimeve ndaj publikut, përgjegjësisë dhe korrektësisë për kryerjen e misionit dhe të detyrave të ngarkuara. Shërbimi Pyjor vepron në pyjet dhe kullotat në pronësi të Bashkisë, në territorin administrativ të saj. Punonjësit e shërbimit pyjor pajisen me uniformë me shenja dalluese, dokument identifikimi dhe mjete të tjera teknike të nevojshme për kryerjen e detyrës. Caktimi i rregullave për mbajtjen, përbërjen, afatet e përdorimit e të zëvendësimit të uniformës për punonjësit e shërbimit pyjor publik dhe për inspektorët e policisë pyjore, caktohen me vendim te KM.

**ii. Synimi i projektit**

- Të arrihet menaxhim sa më i mire i pyjeve, sipas udhëzimeve të përcaktuara dhe në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm dhe përdorimit shumëfunksional të tyre me ndikim të fuqishëm në rritjen ekonomike të Bashkisë , kryesisht të komunitetit që i përdor ato.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

1. Administrim i burimeve njerzore për kryerjen e funksionit.
2. Ndjekje dhe evidentim në vijimësi i ndryshimeve që pësojnë pyjet, kullotat e livadhet, nga ndotjet atmosferike, dëmtuesit, sëmundjet, zjarret e faktorë të tjerë, me ndikime në treguesit e ekosistemeve pyjore e kullosore dhe të biodiversitetit, si dhe merr masave të nevojshme në zbatim të Ligjit organik.
3. Përditësim në vijimësi i ndryshimeve që pëson fondi pyjor kullosor , si rezultat i zbatimit të punimeve dhe ndërhyrjeve që kryhen në fondin pyjor e kullosor, si dhe nga shkaqe ose faktorë të ndryshëm.
4. Zbatim i Planit operacional vjetor për aktivitetet vjetore në pyje dhe kullota, bazuar në të dhënat e planit të mbarështhimit të pyjeve dhe kullotave për vitin referues, në plani e mbarështhimit.
5. Planifikim i mundësisë vjetore të shfrytëzimit dhe vëllimit të materialit te druve te zjarrit , per nevojat e popullsise bashkise si edhe punimet në fondin pyjor/kullosor.
6. Hartim apo mirëmbajtje e përditësim i kadastrës pyjore/kullosore.

**b) Rezultatet që prisni**

- Funksionimi i strukturës së re të krijuar

| c) Aktorët e mundshëm | d) Kontributet e mundshme në projekt |
|---|---|
| | Bashkia Shkodër |

**e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii)**

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2017** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Sherbimi i administrimit te pyjeve e kullotave | 3679 | 2813 | 447 | 419 | | |
| | **Shuma** | **3679** | **2813** | **447** | **419** | | |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2018** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Sherbimi i administrimit te pyjeve e kullotave | 3744 | 2870 | 455 | 419 | | |
| | **Shuma** | **3744** | **2870** | **475** | **419** | | |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2019** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Sherbimi i administrimit te pyjeve e kullotave | 3811 | 2927 | 465 | 419 | | |

<table>
<tr><td></td><td>Shuma</td><td>3811</td><td>2927</td><td>465</td><td>419</td><td></td><td></td></tr>
<tr><td colspan="2">f) Periudha e zbatimit<br>janar 2017 – dhjetor 2017<br>janar 2018 – dhjetor 2018<br>janar 2019 – dhjetor 2019</td><td colspan="6">g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:<br>Drejtoria e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave/Drejtoria e Sherbimeve bujqesore e pyjore.</td></tr>
</table>

| | | |
|---|---|---|
| Nr.12 | **Projekti : P8.F4.O2.A1.**<br>Rishikimi/hartimi i Planit te Menaxhimit te pyjeve e kullotave per NJA Shale, Postribe | **Llojet e programit : P8** Mjedisi dhe mbrojtja e Pyjeve e kullotave.<br><br>**Funksioni P8.F4. :** Administrimin e pyjeve dhe kullotave vendore si dhe menaxhimin e institucioneve ne sherbim te ketij funksioni sipas menyres se percaktuar me ligj |

**a)Përshkrimi i shkurtër i projektit**
Rishikimi/hartimi i planit te Menaxhimit te Pyjeve e Kullotave per NJA Shale Postrribe.

**i. Situata**

Pergatitja e planeve të menaxhimit apo rishikimi i tyre , nëpërmjet studimit dhe analizave të të gjithë elementeve , treguesve sasiore dhe cilesorë përcaktimi i prioriteteve per nderhyrje ne zonat pyjore/kullosore do te beje qe te kemi nje zhvillimit të qëndrushëm ,në funksion të rritjes së kapaciteteve prodhuese e të përmirsimit të funksoneve të tjera që këto pyje e kullota afrojnë .

**ii. Synimi i projektit**

Të përmirësohet kontrolli mbi territorin për një planifikim më të mirë të përdorimit të resursëvë natyrore dhe mbrojtjes së tyre. Përputhja e projektit me Qëllimet dhe Objektivat e Programit të cilat projekti do të ndihmojë të realizohen si Hartimin e politikave per menaxhimin e qendrueshem te pyjeve dhe kullotave, zhvillimin e nje ekonomie te gjelber, koordinimin ne nivel rajonal dhe lokal te praktikave me te mira ne fondin pyjor dhe kullosor, eficiente nga pikpamja ekonomike, miqësore me mjedisin dhe të pranuara nga shoqëria.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

Referuar edhe projektit te regjistrimit dhe inventarizimit te pronave te realizohen hap mbas hapi rishikimet e planeve apo edhe hartimet e tyre per zonat sipas parashikimeve.
Mbledhja e informacionit të nevojshem dhe përdorimi i tij në funksion të orientimit të ndërhyrjeve. Koordinimi i informacionit të mbledhur me drejtoritë e linjës në Bashkinë Shkodër dhe institucionet e tjera që kanë të bëjnë me administrimin e pyjeve dhe kullotave.

**b) Rezultatet që prisni**

Hartimi i planeve te menaxhimit eshte dokumenti strategjik me i rendesishem ne fushen e menaxhimit dhe kontrollit ne pyje dhe kullota. Hartimi i tyre

- planifikimin dhe orjenton investimet ne kete fushe .
- parandalo e situatat e pakendeshme që krijohen në raste të veçanta.

| **c) Aktorët e mundshëm (grupet që lidhen me projektin dhe që ndikohen)** | **d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht etj.)** |
|---|---|
| Bashkia Shkodër<br>Ministria e Mjedisit<br>CNVP,Shoqata e përdorimit të pyjeve<br>Organizata të cilat mbështesin aktivitetin e pyje/kullota. | Bashkia Shkoder |

**e) Shpenzimet e llogaritura ( per cdo aktivitet të mësiperm (pika iii)**

<table>
<tr><td colspan="2" rowspan="2">Shpenzimet për çdo aktivitet 2017</td><td rowspan="2">Totali (mije lekë)</td><td colspan="5">Nga kjo:</td></tr>
<tr><td>Paga</td><td>Sigurime</td><td>Operative</td><td>Transferim e</td><td>Kapitale</td></tr>
<tr><td>A.1</td><td>Rishikimi/hartimi i Planit te Menaxhimit te pyjeve e kullotave per NJA Shale, Postribe</td><td>0</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr>
<tr><td></td><td>Shuma</td><td>0</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr>
<tr><td colspan="2" rowspan="2">Shpenzimet për çdo aktivitet 2018</td><td rowspan="2">Totali (mije lekë)</td><td colspan="5">Nga kjo:</td></tr>
<tr><td>Paga</td><td>Sigurime</td><td>Operative</td><td>Transferim e</td><td>Kapitale</td></tr>
<tr><td>A.1</td><td>Rishikimi/hartimi i Planit te Menaxhimit te pyjeve e kullotave per Shosh, Pult</td><td>0</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr>
<tr><td></td><td>Shuma</td><td>0</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr>
<tr><td colspan="2" rowspan="2">Shpenzimet për çdo aktivitet 2019</td><td rowspan="2">Totali (mije lekë)</td><td colspan="5">Nga kjo:</td></tr>
<tr><td>Paga</td><td>Sigurime</td><td>Operative</td><td>Transferim e</td><td>Kapitale</td></tr>
<tr><td>A.1</td><td>Rishikimi/hartimi i Planit te Menaxhimit te pyjeve e kullotave per Guri i Zi , Rrethina, Berdice</td><td>0</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr>
<tr><td></td><td>Shuma</td><td>0</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr>
</table>

| **f) Periudha e zbatimit** | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:** |
|---|---|
| janar 2017 – dhjetor 2017<br>janar 2018 – dhjetor 2018<br>janar 2019 – dhjetor 2019 | Drejtoria e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave/Drejtoria e Sherbimeve bujqesore e pyjore. |

<table>
<tr><td>r 13</td><td>Projekti : P8.F4.O2.A2.<br>Realizimi i regjistrimit dhe inventarizimit te Pyjeve dhe kullotave bashkiake prane ZVRPP .</td><td>Llojet e programit : P8 Mjedisi dhe mbrojtja e Pyjeve e kullotave.<br><br>Funksioni P8.F4. : Administrimin e pyjeve dhe kullotave vendore si dhe menaxhimin e institucioneve ne sherbim te ketij funksioni sipas menyres se percaktuar me ligj</td></tr>
</table>

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit**

**i.Situata.**

Gjendja e kadastres se pyjeve dhe kullotave ne vendin tone i referohet viteve 1985-1990. Aktualisht nuk ka nje kadaster te azhornuar te pyjeve e kullotave si edhe invenatrizim te fondit pyjor . Si e tille Ministria e Mjedisit ka marre iniciativen qe ne kuader te " projektit te Sherbimeve Mjedisore " ne bashkepunim edhe me pushtete vendore te mund te realizohet ky proces. Pjese e ketij procesi shume te rendesishem do te jete edhe bashkia Shkoder/Drejtoria e mjedisit , Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave.
Në kuadër te Ligjit nr 115/2014 "Për ndarjen administrative – territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", Bashkia Shkodër përbëhet: nga 11 njësi administrative, të cilat janë: Shkodër, Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, Guri i Zi, Postribë, Pult, Rrethinat, Shalë, Shosh dhe Velipojë. Pjesë e pronave të Bashkisë aktuale jane edhe pyjet/kullotat. Me VKM nr 433/2016 eshte bere Transferimi ne pronesi te Bashkise Shkoder i pyjeve dhe kullotave publike te cilat kane qene nen administrim te MM dhe ish komunave.
Regjistrimi i të gjithë pyjeve/kullotave përveçse një sfidë, është edhe detyrim ligjor. Kjo kërkon hartimin/përgatitjen e dokumetacionit për rilevimet topografike për të realizuar regjistrimin e ketyre pronave.
Ne bashkepunim me aktoret e tjere ne kete proces do te percaktohen edhe NJA per te cilat do te realizohet ky regjistrim/inventarizim.

**ii. Synimi i projektit :**

- Databaze e sakte e siperfaqeve te pyjeve dhe kullotave bashkiake /regjistrim ne ZVRPP si dhe orjentim i drejte i financimeve ne fushen e sherbimeve mjedisore /pyje.
- Të arrihet menaxhim sa më i mire i pyjeve, sipas udhëzimeve të përcaktuara dhe në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm dhe përdorimit shumëfunksional të tyre me ndikim të fuqishëm në rritjen ekonomike të Bashkisë , kryesisht të komunitetit që i përdor ato.
- Të përmirësohët qeverisja vendore dhe ofrimi i shërbimeve ndaj qytetarëve.
- Qëllimi themelor i këtij projekti është regjistrimi pranë ZVRPP Shkodër i të gjitha pyjeve/kullotave të cilat janë pronë e bashkisë Shkodër sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave për inventarin e pyjeve/kullotave që kalojnë në pronësi të bashkise.
- Ky eshte nje projekt qe ka nje kohezgjatje te pakten 3 vjecare.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit .**

1. Bashkepunimi me Ministrine e Mjedisit / Organizatat e tjera si CNVP , Shoqatat e Pyjeve etj
1. Përgatitja e materialeve hartat, relacione, dokumentacion për të regjistruar pranë ZVRPP Shkodër .

**b) Rezultatet qe prisni**

- Regjistrimi i pronave pyje/kullota dhe marrja e çertifikatës/Vertetimit Hipotekor për pasuritë e rregjistruara.

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|
| Bashkia Shkodër<br>Ministria e Mjedisit<br>CNVP<br>Shoqata e përdorimit të pyjeve<br>Organizata të cilat mbështesin aktivitetin e pyje/kullota. | Bashkia Shkoder |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2017** | | Totali ( mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Siguri me | Opera tive | Transf erime | Kapitale |
| A.1 | Përgatitja e materialeve hartat, relacione, dokumentacion për të regjistruar pranë ZVRPP Shkodër pyjet dhe kullotat e transferuara. | | | | | | |
| | **Shuma** | | | | | | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2018** | | Totali ( mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Siguri me | Opera tive | Transf erime | Kapitale |
| A.1 | Përgatitja e materialeve hartat, relacione, dokumentacion për të regjistruar pranë ZVRPP Shkodër pyjet dhe kullotat e transferuara | | | | | | |
| | **Shuma** | | | | | | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2019** | | Totali ( mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Siguri me | Opera tive | Transf erime | Kapitale |
| A.1 | Përgatitja e materialeve hartat, relacione, dokumentacion për të regjistruar pranë ZVRPP Shkodër pyjet dhe kullotat e transferuara | | | | | | |
| | **Shuma** | | | | | | |

| | | |
|---|---|---|
| Nr 14 | **Projekti P8.F4.O3.A1.**<br>Hartim i projektit "Rikualifikimi mjedisor/social i guroreve ne malin e Traboshit. | **Llojet e programit: P8** Mjedisi dhe mbrojtja e Pyjeve e kullotave.<br><br>**Funksioni P8.F4.:** Administrimin e pyjeve dhe kullotave vendore si dhe menaxhimin e institucioneve ne sherbim te ketij funksioni sipas menyres se percaktuar me ligj |

**a) Pershkrimi i shkurter i projektit :** Projetimi dhe zbatimi i rikualifikimit mjedisor/ social i gurores që përfshin sistemimin ambiental të sipërfaqes së gurores me peme dhe bimesi rekreative duke e kthyer ish-guroren në një vend më të sigurtë dhe duke lënë mundësinë e një zhvillimi të qëndrueshëm të zonës përreth.

**i. Situata**

Germimet e kryera ndër vite dhe çarjet e krijuara për nxjerrje inertesh kanë bërë që shumë nga drurët pyjorë të dëmtohen plotësisht duke çuar drejt zhdukjes së tyre. Ndër të tjera ky gërmim ka qenë burim ndotje per mjedisin e zones, ka demtuar pejsazhin dhe ka zhvilluar fenomenin e erozionit të tokës duke shkaktuar demtime serioze të mjedisit.

**ii. Synimi i projektit**

- Përmirësimi apo rehabilitimi i sipërfaqeve të zhveshura nga bimësia dhe të degraduar nga aktiviteti njerëzor. Rehabilitimi mjedisor i gurores ul rrezikshmërinë e rrëshqitjeve masive të dheut, shton sipërfaqet e gjelbërta duke përmirësuar cilësinë e ajrit dhe duke krijuar edhe një fasadë të gjelbër për zonën. Ky projekt sigurisht që ndikon edhe ndjeshmërinë pozitive që ofron krijimi i një sipërfaqe qetësuese në rotondon e Urës së Bunës.

**iii. Aktivitetet kryesorete projektit**

- Studimi ekologjik dhe ekonomiko-shoqeror i zonës , në funksion të llojeve që duhen të pëërdoren për realizimin e objktivit të përgjithshëm të projektit.
- Ndërgjgjësimi i të gjithë grupeve të interesit dhe qytetareve për të mundësuar realizimin e qëllimit dhe minimizimin maksimal të risqeve.
- Hartimi dhe zbatimi i projektit teknik.
- Mbrojtja, mirëmbajtja e objektit përgjatë të gjitha fazave të projektit.

**b) Rezultatet qe prisni ( sherbimet apo produktet qe u dorezoni perfituesve te synuar)**

- Pyllezimi i siperfaqeve te demtuara dhe shume te demtuara.
- Gjelberimi i kurores se qytetit
- Permiresimi i cilesise se ajrit.

| **c) Aktoret e mundshem** | **d) Kontributet e mundshme ne projekt** |
|---|---|
| Bashkia Shkoder<br>Komuniteti i zonave<br>Shoqatat e pyjeve<br>Shoqatat mjedisore | Bashkia Shkoder<br>Shoqatat e pyjeve<br>Shoqatat Mjedisore<br>Vullnetare |

**e) Shpenzimet e llogaritura**

| **Shpenzimet per cdo aktivitet** | | Totali (000 lek) | Nga kjo: | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga, sig | operative | kapitale |
| | | | | | |
| | **Shuma** | **0** | | | |

| **f) Periudha e zbatimit** | **g) Pergatiti dhe ndjek realizimin e projektit:** |
|---|---|
| Janar- Dhjetor 2017 | Drejtoria e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave/ Drejtoria e Sherbimeve Bujqesore e Pyjore |

| Nr 15 | **P8.F4.O3.A2.**<br>Ndertim i pritave malore ne siperfaqet pyjore të NJA postrribe dhe Guri i ZI. | **Llojet e programit : P8** Mjedisi dhe mbrojtja e Pyjeve e kullotave.<br><br>**Funksioni P8.F4. :** Administrimin e pyjeve dhe kullotave vendore si dhe menaxhimin e institucioneve ne sherbim të ketij funksioni sipas menyres se percaktuar me ligj |
|---|---|---|

**a) Pershkrimi i shkurter i projektit :** Ndertim i pritave malore ne siperfaqet pyjore te NJA postrribe dhe Guri i ZI.

**i. Situata**

Realizimi i sherbimit të Administrimit të Pyjeve /kullotave bazohet ne Ligin nr 9385/2005 ( i ndryshuar) “ Per Pyjet dhe Sherbimin pyjor “.Erozioni është fenomeni që shoqëron të gjitha tokat pyjore,pavarsisht nga terrenet ku ato janë të instaluar pyjet artificilisht apo natyralisht ,kjo për shkak sepse jo gjithmon planifikohën e zbatohën punime, ne kohën e duhur dhe konform kushteve teknike.Ky fenomen ndodh edhe për shumë shkaqe natyrore apo edhe nga veprimtaria prodhuëse e njeriut.
Ne kuader të mbrojtjes së pyjeve dhe sherbimit ndaj tyre Bashkia Shkoder planifikon të kryeje punime të “ Ndertimit të pritave mbrojtese”.
Keshtu parashikohet të nderhyet me “ Ndertim prita malore” ne zonen e Postrribes dhe Gurit të Zi , kryesisht ne perrenjte e faqes perendimore të Lumit Kir.

**ii. Synimi i projektit**

Për luftimin e erozionit do të ndërtohën prita me mur guri të thatë, të cilat do të ndërtohen kryesisht në përrenj,
Realizimi i projektit do të beje ruajtjen e tokes nga erozioni dhe ka ndikim ne permiresimin e situates mjedisore e sociale.
Punimet do të jene kryesisht punime me gur të thate, pa perdorur betonin, por njekohesisht edhe duke u bazuar ne parimin “sa me shume mure afer njeri tjetrit dhe jo mure të larte e larg njeri tjetrit”.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

1. Hartimi i projektit
2. Zbatimi i projektit sipas fazave të parashikuara.

**b) Rezultatet qe prisni**

- Mbrojtja e tokes nga erozioni.
- ndikim pozitiv edhe mjedis edhe ne komunitet.

| **c) Aktoret e mundshem** | **d) Kontributet e mundshme ne projekt** |
|---|---|
| Bashkia Shkoder<br>Komuniteti i zonave<br>Shoqatat e pyjeve<br>Shoqatat mjedisore | Bashkia Shkoder<br>Shoqatat e pyjeve<br>Shoqatat Mjedisore<br>Vullnetare |

**e) Shpenzimet e llogaritura**

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2017** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | **Ndertim prita malore ne Postribe, Guri i zi:** | 3000 | | | | | 3000 |
| | **Shuma** | **3000** | | | | | **3000** |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2018** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | **Ndertim prita malore ne Shale** | 3000 | | | | | 3000 |
| | **Shuma** | **3000** | | | | | **3000** |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2019** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | **Ndertim prita malore ne Shosh Pult** | 3000 | | | | | 3000 |
| | **Shuma** | **3000** | | | | | **3000** |

| **f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon)**<br>janar 2017 – dhjetor 2017<br>janar 2018 – dhjetor 2018<br>janar 2019 – dhjetor 2019 | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave/Drejtoria e Sherbimeve bujqesore e pyjore. |
|---|---|

| | | |
|---|---|---|
| Nr 16 | **Projekti P8F4O3A3:** Pyllezime i Siperfaqeve pyjore. NjA, Rrethina ,Guri i ZI | **Llojet e programit : P8** Mjedisi dhe mbrojtja e Pyjeve e kullotave.<br><br>**Funksioni P8.F4. :** Administrimin e pyjeve dhe kullotave vendore si dhe menaxhimin e institucioneve ne sherbim të ketij funksioni sipas menyres se percaktuar me ligj |

**a) Pershkrimi i shkurter i projektit :** Pyllezime i Siperfaqeve pyjore. NjA Rrethina , Guri i ZI.

**i. Situata**

Mbrojtja dhe Administrimi i Pyjeve /Kullotave ka kaluar si veprimtari e Njesise se Qeverisjes Vendore- Bashkia Shkoder nepermjet Ligjit nr 139/2015 " Per veteqeverisjen vendore". Realizimi i sherbimit të Administrimit të Pyjeve /kullotave bazohet ne Ligin nr 9385/2005 ( i ndryshuar) " Per Pyjet dhe Sherbimin pyjor ".
Ne kuader të mbrojtjes dhe riperteritjes se pyjeve dhe sherbimit ndaj tyre Bashkia Shkoder planifikon të kryeje punime të pyllezimit kryesisht ne zona të demtuara dhe shume të demtuara.
Keshtu parashikohet të nderhyet me pyllezim ne zonen e Kodrave të Rencit , zone e cila ndodhet ne NJA Guri i Zip o asht edhe nje pjese e cila ndodhet ne NJA Rrethina. Kjo zone është shume e demtuar , siperfaqja e kesaj zone është rreth 50 Ha. Demtimet ne kete zone kane erdhur si rezultat i zjarreve si edhe prerjes pa kriter të trruve. Kjo ka bere qe zona të jete shume e ekzpozuar edhe ndaj faktoreve të erozionit të cilet sjellin edhe humbjen e tokes.

**ii. Synimi i projektit**

Zhvillimin e një kapitali mjedisor, social e kulturor që do të garantojë kushtet për zhvillim të qëndrueshëm. Sensibilizimin e komunitetit që banon rreth zonës në fjalë për fushatën e pyllëzimeve si edhe rëndësinë nepermjet nderhyrjeve me punime rihabilituese pyllezimi, do të rritet siperfaqia e gjelbert/banore të zones, rritja e ndikimeve positive ne mjedis ne ruajtjen e tokes,ujrave dhe të ajrit dhe se fundi ndikimi i pyllit mbi kushtet social ekonomike të komunitetit dhe agro-turizem.
Masivi pyjore qe do të krijohet,do të permiresoj ndjeshem kushtet eko-mjedisore të Qytetit të Shkodres e me gjere duke permiresuar ndjeshem anen shendetsore të popullesise të zones per rreth.
Nderhyrja qe propozohet të kryhet ne kete zone ka të beje me gjelberimin e kurores se qytetit. Propozohet të mbillet pishe mesdhetare si nje lloj druri qe rritet ne kete zone. Bazuar ne normativat e pyllezimit nevojiten rreth 2500 pisha per 1 ha. Realizimi i projektit do të kryhet me etapa sepse edhe menaxhimi është me i mire.
Pyllezimi si nje faktor shume i rendesishem ne cilesine e ajrit, jeten e shendeteshme, mbrojtjen e tokes etj.

**iii. Aktivitetet kryesorete projektit**

1. Hartimi i projektit
2. Zbatimi i projektit sipas fazave të parashikuara.

**b) Rezultatet qe prisni**

- Pyllezimi i siperfaqeve të demtuara dhe shume të demtuara.
- Gjelberimi i kurores se qytetit
- Permiresimi i cilesise se ajrit..

| **c) Aktoret e mundshem** | **d) Kontributet e mundshme ne projekt** |
|---|---|
| Bashkia Shkoder<br>Komuniteti i zonave<br>Shoqatat e pyjeve<br>Shoqatat mjedisore | Bashkia Shkoder<br>Shoqatat e pyjeve<br>Shoqatat Mjedisore<br>Vullnetare |

**e) Shpenzimet e llogaritura ( per cdo aktivitet të mesiperme (pika iii)**

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2017** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transfer ime | Kapitale |
| A.1 | Pyllezim ne siperfaqet pyjore ne Rrethina dhe Guri i ZI | 0 | | | | | 528 lek/ha pyllezim |
| | **Shuma** | **0** | | | | | **0** |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2018** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transfer ime | Kapitale |
| A.1 | Pyllezim ne siperfaqet pyjore ne Postrribe Berdice | 0 | | | | | 528 lek/ha |
| | **Shuma** | **0** | | | | | **0** |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2019** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transfer ime | Kapitale |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A.1 | Pyllezim ne siperfaqet pyjore Pult Shale Shosh | 0 | | | | | 528 lek/ha |
| | **Shuma** | **0** | | | | | **0** |

| | |
|---|---|
| **f) Periudha e zbatimit**<br>janar 2017 – dhjetor 2017<br>janar 2018 – dhjetor 2018<br>janar 2019 – dhjetor 2019 | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave/Drejtoria e Sherbimeve bujqesore e pyjore. |

| | | |
|---|---|---|
| Nr 17 | **Projekti P8F4O3A4 :** Pastrimi/permiresimi i parcelave pyjore. NjA, Rrethina, Postrribe, Pult . | **Llojet e programit : P8** Mjedisi dhe mbrojtja e Pyjeve e kullotave.<br><br>**Funksioni P8.F4. :** Administrimin e pyjeve dhe kullotave vendore si dhe menaxhimin e institucioneve në sherbim të ketij funksioni sipas menyres se percaktuar me ligj |

**a) Pershkrimi i shkurter i projektit :** Pastrimi/permiresimi i parcelave pyjore. NjA, Rrethina, Postrribe, Pult

**i. Situata**

Realizimi i sherbimit të Administrimit të Pyjeve /kullotave bazohet në Ligin nr 9385/2005 ( i ndryshuar) " për Pyjet dhe Sherbimin pyjor ".
Ne kuader të mbrojtjes dhe riperteritjes se pyjeve dhe sherbimit ndaj tyre Bashkia Shkoder planifikon të kryeje punime të pastrimit /permiresimit të parcelave pyjore në NJA Rrethina, Postrribe dhe Pult. Pylli në zonen e propozuar ka dendesi të ndryshme pavarsisht se mbjellja mund të jete bere me skeme afersisht të rregullt. Kurora ka zhvillime të ndryshme dhe në nje pjese të konsiderushme grumbulli pyjor (druret perberes) nuk jane vete krasite, apo deget e poshteme jane thare por nuk jane shkeputur nga trungu i drurit.Gjithashtu si pasoje e djegejeve nder vite druret e djegur për mungese fondesh nuk jane hequr. në pjeset ku grumbulli pyjor është me kurore dendesi me të ulet qe reziston dhe mbijeton nenepylli është i perbere nga lloje të ndryshme shkurrore etj.Te gjitha keto e kane bere objektin me të ekzpozuar nga rreziku i djegejeve nga zjarret e mundeshme.

**ii. Synimi i projektit**

- Nderhyrje me rrallime në 10-15 % të numrit të drureve ,duke hequr drure të bigezuar, të thate etj.
- Krasitje të degeve të poshteme të pishave deri në 1/3 e kurores.
- Prerja e shkurreve, ferrave të demshme dhe pastrimi i mbeturinave, grumbullimi i tyre në vende të caktuara (perrenj çeltira etj).Kjo detyre do të kryhet krahas punimeve të krasitjes.
- Nisur nga të gjitha keto konsiderata, është pare e arsyeshme dhe madje e domosdoshme, qe të ndermerren punime me karakter sherbimi për parandalimine mundesise se renies se zjarreve,dhe për raste kure bien të behet i mundeshem minimizimi i tyre.

**iii. Aktivitetet kryesorete projektit**

1. Hartimi i projektit
2. Zbatimi i projektit sipas fazave të parashikuara.

**b) Rezultatet qe prisni**

- Qëllimi i përgjithshëm është mbrojtja e mjedisit natyror, Për më tepër, synon zhvillimin e një kapitali mjedisor, social e kulturor që do të garantojë kushtet për zhvillim të qëndrueshëm.
- Me ane të permiresimit (Rrallime+ Krasitje, pastrim shkurre) arrihet ruajtja e objekteve të veshura me peme nga renia e zjarreve në pyje, pasi në pyjet halore zjarri është me evident në çdo kohe,si dhe stimulohet instalimi dhe ruajtja e filizerise.

| c) Aktoret e mundshem | d) Kontributet e mundshme në projekt |
|---|---|
| Bashkia Shkoder<br>Komuniteti i zonave<br>Shoqatat e pyjeve<br>Shoqatat mjedisore | Bashkia Shkoder<br>Shoqatat e pyjeve<br>Shoqatat Mjedisore<br>Vullnetare |

**e) Shpenzimet e llogaritura**

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2017** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Pastrimi/permiresimi i parcelave pyjore në Rrethina, Postribe, Pult. | 1000 | | | 1000 | | |
| | **Shuma** | **1000** | | | 1000 | | |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2018** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Pastrimi/permiresimi i parcelave pyjore në Shale, Shosh | 1000 | | | 1000 | | |
| | **Shuma** | **1000** | | | 1000 | | |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2019** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Pastrimi/permiresimi i parcelave pyjore në Guri i zi, Berdice | 1000 | | | 1000 | | |
| | **Shuma** | **1000** | | | 1000 | | |

| | |
|---|---|
| **f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon)**<br>janar 2017 – dhjetor 2017<br>janar 2018 – dhjetor 2018<br>janar 2019 – dhjetor 2019 | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave/Drejtoria e Sherbimeve bujqesore e pyjore. |

| Nr 18 | **Projekti P8F4O3A5 :**<br>FV sinjalistike pyjore . NjA, Rrethina Pult, Postrribe. | **Llojet e programit : P8** Mjedisi dhe mbrojtja e Pyjeve e kullotave.<br><br>**Funksioni P8.F4. :** Administrimin e pyjeve dhe kullotave vendore si dhe menaxhimin e institucioneve në sherbim të ketij funksioni sipas menyres se percaktuar me ligj |
|---|---|---|

**a) Pershkrimi i shkurter i projektit:**

**i. Situata**

Mbrojtja dhe Administrimi i Pyjeve /Kullotave ka kaluar si veprimtari e Njesise se Qeverisjes Vendore- Bashkia Shkoder nepermjet Ligjit nr 139/2015 “ për veteqeverisjen vendore”. Realizimi i sherbimit të Administrimit të Pyjeve /kullotave bazohet në Ligin nr 9385/2005 ( i ndryshuar) “ për Pyjet dhe Sherbimin pyjor “.
Aktualisht Bashkia Shkoder ka nen administrim rreth 44.000 ha pyje e kullota. i gjithe ky fond pyjor kerkon edhe nje sinjalistike si informuese por edhe orjentuese e lajmeruese. Aktualisht kjo sinjalistike nuk ekziston ose në disa raste eshte jashte standarteve optimale ( tabela të demtuara me shkrime të fshira)

**ii. Synimi i projektit**

- Nje qeverisje e mire e fondit pyjor kerkon edhe nje nderhyrje në lajmerimin/paralajmerimin apo orjentimin e zonave. Keshtu vendosja e sinjalistikes për lojet e pyjeve, rruget pyjore, njoftimet për ndalimet e hyrjeve në pyje , ruajtjen e tyre nga zjarri etj, eshte nje nga synimet e projektit.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

1. Hartimi i projektit
2. Zbatimi i projektit sipas fazave të parashikuara.

**b) Rezultatet qe prisni**

- Vendosja e sinjalistikes pyjore për orjentim, njoftim e mbrojtje të pyjeve.
- Krijimi i kushteve për shfrytezim sa me të mire të tyre.

| c) Aktoret e mundshem | d) Kontributet e mundshme në projekt |
|---|---|
| Bashkia Shkoder<br>Komuniteti i zonave<br>Shoqatat e pyjeve<br>Shoqatat mjedisore | Bashkia Shkoder<br>Shoqatat e pyjeve<br>Shoqatat Mjedisore<br>Vullnetare |

**e) Shpenzimet e llogaritura ( për cdo aktivitet të mesiperme (pika iii)**

| f) Periudha e zbatimit(kur fillon, kur perfundon) | g) Pergatiti dhe ndjek realizimin e projektit: |
|---|---|
| **Janar- Dhjetor 2017** | **Drejtoria e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave/ Drejtoria e Sherbimeve Bujqesore e Pyjore** |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2017** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Sinjalistike pyjore në Rrethina, Pult Postrribe | 200 | | | 200 | | 0 |
| | **Shuma** | **200** | | | 200 | | **0** |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2018** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Sinjalistike pyjore në Shale, Shosh | 200 | | | 200 | | |
| | **Shuma** | **200** | | | 200 | | |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2019** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Sinjalistike pyjore në Berdice, Guri i Zi | 200 | | | 200 | | |
| | **Shuma** | **200** | | | 200 | | |

| **f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon)** | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:** |
|---|---|
| janar 2017 – dhjetor 2017<br>janar 2018 – dhjetor 2018<br>janar 2019 – dhjetor 2019 | Drejtoria e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave/Drejtoria e Sherbimeve bujqesore e pyjore. |

<table>
<tr><td>Nr 19</td><td>Projekti P8F4O3A6:<br>Luftimi i semundjeve dhe demtuesve ne pyje. NjA, Rrethina,Shosh, Pult .</td><td>Llojet e programit : P8 Mjedisi dhe mbrojtja e Pyjeve e kullotave.<br><br>Funksioni P8.F4. : Administrimin e pyjeve dhe kullotave vendore si dhe menaxhimin e institucioneve ne sherbim te ketij funksioni sipas menyres se percaktuar me ligj</td></tr>
<tr><td colspan="3">a) Pershkrimi i shkurter i projektit: Luftimi i semundjeve dhe demtuesve ne pyje. NjA, Rrethina,Shosh, Pult .</td></tr>
<tr><td colspan="3">i. Situata</td></tr>
<tr><td colspan="3">Realizimi i sherbimit te Administrimit te Pyjeve /Kullotave bazohet ne Ligin nr. 9385/2005 ( i ndryshuar) “ Per Pyjet dhe Sherbimin pyjor “.<br>Ne kuader te mbrojtjes dhe riperteritjes se pyjeve dhe sherbimit ndaj tyre Bashkia Shkoder planifikon te kryeje punime te luftimit te semundjeve dhe demtuesve kryesisht ne pyje.<br>Pyjet sic do lloj qenie bioligjike preken nga demtuesit dhe dhe semundjet , duke u shkaktuar deme tek llojet drusore ne ulje te fuqise vegjetative , frenim te rritjes dhe zhvillim normal te tyre. Moslufitmi i tyre con deri ne tharrjen e drureve.<br>Ne zonat pyjore sipas llojit te drurit jane verifikuar semundje dhe demtues te ndryshem , keshtu eshte vene re kanceri i geshtenjes, gjethperdreresja e dushkut, hiri i dushkut etj</td></tr>
<tr><td colspan="3">ii. Synimi i projektit</td></tr>
<tr><td colspan="3">• Nderhyrja ne kohe per luftimin e semundjes se kancerit te geshtenjes , do te sjelle permiremiresimin e situates duke rritur fuqine vegjetative te drurit si edhe prodhimein e geshtenjes.<br>• Po keshtu nderhyrja ne pyjet e dushkut duke luftuar hirin apo gjetheperdreresen do te ndikoje ne permiresimin e fuqise vegjetative, mbrojtjen nga tharrja e tyre.</td></tr>
<tr><td colspan="3">iii. Aktivitetet kryesorete projektit ( Veprimet qe do te ndermerrni per te prodhuar rezultate)</td></tr>
<tr><td colspan="3">1. Hartimi i projektit<br>2. Zbatimi i projektit sipas fazave te parashikuara.</td></tr>
<tr><td colspan="3">b) Rezultatet që prisni</td></tr>
<tr><td colspan="3">• Qëllimi i përgjithshëm është mbrojtja e mjedisit natyror, Për më tepër, synon zhvillimin e një kapitali mjedisor, social e kulturor që do të garantojë kushtet për zhvillim të qëndrueshëm.<br>• Me ane te permiresimit (luftimi nga semundjet /demtuesit) arrihet ruajtja e pyjeve, fuqia vegjetative e tyre e cila ndikon drejtperdrejt ne permiresimin e mjedisit pyjor dhe atij social.</td></tr>
<tr><td colspan="2">c) Aktoret e mundshëm</td><td>d) Kontributet e mundshme ne projekt</td></tr>
<tr><td colspan="2">Bashkia Shkoder<br>Komuniteti i zonave<br>Shoqatat e pyjeve<br>Shoqatat mjedisore</td><td>Bashkia Shkoder<br>Shoqatat e pyjeve<br>Shoqatat Mjedisore<br>Vullnetare</td></tr>
<tr><td colspan="3">e) Shpenzimet e llogaritura</td></tr>
</table>

<table>
<tr><td colspan="2" rowspan="2">Shpenzimet për çdo aktivitet 2017</td><td rowspan="2">Totali (mije lekë)</td><td colspan="5">Nga kjo:</td></tr>
<tr><td>Paga</td><td>Sigurim e</td><td>Operati ve</td><td>Transfer ime</td><td>Kap itale</td></tr>
<tr><td>A.1</td><td>Luftimi i semundjeve dhe demtuesve ne pyje/kullota ne qytetin Rrethina, Pult Postrribe</td><td>500</td><td></td><td></td><td>500</td><td></td><td>0</td></tr>
<tr><td></td><td>Shuma</td><td>500</td><td></td><td></td><td>500</td><td></td><td>0</td></tr>
<tr><td colspan="2"></td><td colspan="6"></td></tr>
<tr><td colspan="2" rowspan="2">Shpenzimet për çdo aktivitet 2018</td><td rowspan="2">Totali (mije lekë)</td><td colspan="5">Nga kjo:</td></tr>
<tr><td>Paga</td><td>Sigurim e</td><td>Operati ve</td><td>Transfer ime</td><td>Kap itale</td></tr>
<tr><td>A.1</td><td>Luftimi i semundjeve dhe demtuesve ne pyje/kullota ne ne Shale, Shosh</td><td>500</td><td></td><td></td><td>500</td><td></td><td></td></tr>
<tr><td></td><td>Shuma</td><td>500</td><td></td><td></td><td>500</td><td></td><td></td></tr>
<tr><td colspan="2"></td><td colspan="6"></td></tr>
<tr><td colspan="2" rowspan="2">Shpenzimet për çdo aktivitet 2019</td><td rowspan="2">Totali mije lekë)</td><td colspan="5">Nga kjo:</td></tr>
<tr><td>Paga</td><td>Sigurim e</td><td>Operati ve</td><td>Transfer ime</td><td>Kap itale</td></tr>
<tr><td>A.1</td><td>Luftimi i semundjeve dhe demtuesve ne pyje/kullota ne ne Berdice, Guri i Zi</td><td>1000</td><td></td><td></td><td>1000</td><td></td><td></td></tr>
<tr><td></td><td>Shuma</td><td>1000</td><td></td><td></td><td>1000</td><td></td><td></td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| **f) Periudha e zbatimit**<br>janar 2017 – dhjetor 2017<br>janar 2018 – dhjetor 2018<br>janar 2019 – dhjetor 2019 | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave/Drejtoria e Sherbimeve bujqesore e pyjore. |

| Nr 20 | **Projekti P8F4O3A7:** Zbatimi i projektit per ndertim lere uji ne pyje/kullota NjA, Guri i Zi, Postrribe | **Llojet e programit :** **P8** Mjedisi dhe mbrojtja e Pyjeve e kullotave.<br><br>**Funksioni P8.F4. :** Administrimin e pyjeve dhe kullotave vendore si dhe menaxhimin e institucioneve ne sherbim te ketij funksioni sipas menyres se percaktuar me ligj |
|---|---|---|

**a) Pershkrimi i shkurter i projektit:** Zbatimi i projektit per ndertim lere uji ne pyje/kullota NjA, Guri i Zi, Postrribe

**i. Situata**

Realizimi i sherbimit te Administrimit te Pyjeve /kullotave bazohet ne Ligin nr 9385/2005 ( i ndryshuar) " Per Pyjet dhe Sherbimin pyjor ".
Mungesa e ujit per bagetite ne zonat pyjore e kullosore eshte nje problem mjedisor e social. Keto kullota jane me kapacitet mesatar deri te larta , por shfrytezimi i tyre nuk eshte ne lartesine e duhur per mungese te ujit per kete lind domosdoshmeria e ndertimit te lerave . Ndertim i leres se re per grumbullim dhe mbajtje uji te pijshem per blegtorine me kapacitet 205m3 , per te cilat sigurohet uji per nje numer prej rreth 163 krere te imta dhe 15 krere te trasha

**ii. Synimi i projektit**

- Ndertim i leres se re per grumbullim dhe mbajtje uji te pijshem per blegtorine me kapacitet 205m3 , per te cilat sigurohet uji per nje numer prej rreth 163 krere te imta dhe 15 krere te trasha.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

1. Ndertimi i leres parashikohet te behet ne vend sa me te rrafshet , afer burimeve te grumbullimit te ujit, afer zonave me gure qe te pergoret si material.
2. Projekti permban punime germimi
3. shtrim plasmasi
4. vendosje shtrese dheu mbi plasmas
5. shtresa kalldremi
6. murr rrethues
7. Lera do te ndertohet ne prone te bashkise Shkoder.

**b) Rezultatet qe prisni**

- Qëllimi i përgjithshëm është mbrojtja e mjedisit natyror, Për më tepër, synon zhvillimin e një kapitali mjedisor, social e kulturor që do të garantojë kushtet për zhvillim të qëndrueshëm.
- Sigurimi i ujit te pijshem ne kullota gjate gjithe vitit.Mungesa e te cilit reflektohet ne kapacitetin prodhues te kafshes si edhe ne cilesine e leshit.

| **c) Aktoret e mundshem** | **d) Kontributet e mundshme ne projekt** |
|---|---|
| Bashkia Shkoder<br>Komuniteti i zonave<br>Shoqatat e pyjeve<br>Shoqatat mjedisore | Bashkia Shkoder<br>Shoqatat e pyjeve<br>Shoqatat Mjedisore<br>Vullnetare |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2017** | | Totali ( mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Ndertim lere uji ne Postrribe/Guri i Zi | 1000 | | | | | 1000 |
| | **Shuma** | **1000** | | | | | **1000** |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2018** | | Totali ( mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Ndertim lere uji ne Shosh | 1000 | | | | | 1000 |
| | **Shuma** | **1000** | | | | | **1000** |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2019** | | Totali ( mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Ndertim lere uji ne Shale | 1000 | | | | | 1000 |
| | **Shuma** | **1000** | | | | | **1000** |

| **f) Periudha e zbatimit** | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:** |
|---|---|
| janar 2017-dhjetor2017<br>janar 2018-dhjetor2018<br>janar 2019-dhjetor2019 | Drejtoria e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave/ Drejtoria e Sherbimeve Bujqesore e Pyjore |